

M A N U A L

**LIRIA E MENDIMIT,
NDËRGJEGJES DHE FESË**



Titulli i manualit: **LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË**

Përgatitën për botim: **Prof. Asoc. Dr. Iris Petrela, Ina Xhepa, MSc.**

ISBN:

Ky manual u përgatit nga Qendra Europiane me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer, Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore, në kuadër të projektit “Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë: një eksperience shqiptare”.

Përmbajtja e këtij materiali, opinionet dhe vlerësimet e shprehura në të, janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjithë të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, e mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet ose përdoret me asnjë formë dhe mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

FONDACIONI QENDRA EUROPIANE

Rr. Vaso Pasha, P. 20, Ap. 57
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 451 9076
www.euro-centre.eu

**KONRAD-ADENUER-STIFTUNG E.V.
PROGRAMI I SHTETIT TË SË DREJTËS
PËR EVROPËN JUGLINDORE**

Franzelarilor St. 5, Sektor 2
RO-020785 Bukuresht, Rumani
Tel: +40 21 302 02 63
[https:// www.kas.de/en/web/rlpsee](https://www.kas.de/en/web/rlpsee)

LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË

M A N U A L

Prof. Asoc. Dr. Iris Petrela

| Ina Xhepa, MSc.

Tiranë, 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie.....	7
Metodologjia.....	9
Shkurtime.....	11
Hyrje.....	13

I. STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË, SI DHE E KOMUNITETEVE FETARE

1.1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.....	17
1.2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.....	19
1.2.1 Kuptimi i lirisë së besimit dhe fesë sipas këtyre akteve ndërkombëtare.....	21
1.2.2 Liria për t'u organizuar.....	23
1.2.3 Mosdiskriminimi në bazë të fesë ose besimit.....	24
1.2.4 Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut – roli i tij në mbrojtje të lirisë së besimit dhe fesë.....	27
1.3 Deklarata mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi Bazë të Fesë ose Besimit.....	30

II. GARANTIMI I LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË NË NIVEL RAJONAL – KËSHILLI I EVROPËS

2.1 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.....	35
2.1.1 Kuptimi i lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.....	39
2.1.2 Interpretimi i Nenit 9 të KEDNj-së.....	41
2.1.3 Detyrimet pozitive dhe negative të shtetit.....	46
2.1.4 Mosdiskriminimi në bazë të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.....	49
2.1.5 Lidhja e nenit 9 të Konventës me lirinë e tubimit dhe organizimit.....	51
2.2 Praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut.....	53

III. ASPEKTI KOMBËTAR I LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË

3.1	Këndvështrimi historik i lirisë së mendimit, besimit dhe fesë në shtetin shqiptar.....	75
3.2	Pasqyrimi i lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në paketën kushtetuese shqiptare në vitet '90 dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë prej 1998.....	81
3.2.1	Toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa fetare.....	87
3.2.2	Edukimi fetar në Shqipëri.....	89
3.2.3	Kundërshtimi i ndërgjegjes.....	91
3.3	Institucionet fetare – Bashkësitë fetare në Shqipëri.....	93
3.3.1	Të drejtat që gëzojnë bashkësitë fetare.....	93
3.3.2	Marrëveshjet midis shtetit shqiptar dhe bashkësive fetare.....	94
3.4	Institucionet shtetërore me kompetenca në fushën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë.....	99
3.4.1	Këshilli i Ministrave.....	99
3.4.2	Komiteti Shtetëror i Kulteve.....	102
3.4.3	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....	104
3.4.4	Avokati i Popullit.....	108
3.4.5	Gjykata Kushtetuese.....	111
4.	Detyrimet e Shqipërisë në kuadër të KEDNj.....	111
5.	Kodi Penal në mbrojtje të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.....	113
6.	Vlerësimi i lirive fetare në Shqipëri – Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit (2020).....	115
	Fjalorth.....	119
	Bibliografia.....	121



PARATHËNIE

Ky botim prezantohet në kuadër të Projektit “Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë – një përvojë shqiptare” realizuar me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer - KAS Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore përgjatë muajve korrik – nëntor 2021.

Manuali “Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë – një përvojë shqiptare” është botimi i 2^{të} i Fondacionit Qendra Europiane në kuadër të një serie projektesh dhe botimesh për liritë dhe të drejtat të njeriut, të realizuar me mbështetjen e KAS Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore.

Projekti synon që të ofrojë panoramën e kuadrit normativ vendas, atij në nivel evropian dhe më tej global mbi lirinë e mendimit, besimit dhe fesë duke iu drejtuar një audience, që synon të informohet dhe përditësojë njohuritë mbi kategoritë e lirive dhe të drejtave të njeriut të njohura e të garantuara nga shteti shqiptar si një pjesë e pandashme e realitetit në një shtet demokratik.

Fokusi kryesor i botimit është realiteti shqiptar me zhvillimet legjislativë dhe shoqërore në tri drejtime kryesore lirinë e mendimit, atë të ndërgjegjes dhe fesë, në planin individual, shoqëror dhe të organizuar në formën e besimeve fetare me status juridik, duke trajtuar edhe raportin me shtetin shqiptar.

Një pjesë e manualit që po ju prezantojmë përqendrohet tek kuadri normativ evropian dhe global, që në një masë të konsiderueshme është përthithur në kuadrin normativ vendas bazuar në proceset integruese dhe pjesëmarrëse të Shqipërisë në organizata evropiane dhe botërore.

Manuali synon të gërshetojë trajtimet teorike me gjendjen aktuale në Shqipëri, që prej njohjes dhe shpalljes së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në Kushtetutë në vitin 1998 dhe zhvillimeve në vendin tonë përsa i takon gëzimit dhe mbrojtjes së kësaj lirie gjatë tri dekadave demokraci në vendin tonë me referime në ngjarje dhe zhvillime reale.

Gjithashtu, me anë të këtij botimi synojmë modestisht të plotësojmë zbrazëtinë informative dhe të zgjerojmë njohuritë mbi legjislativën, institucionet dhe mekanizmat që garantojnë dhe mbrojnë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në Shqipëri.



METODOLOGJIA

Puna për hartimin e këtij Manuali u konceptua dhe u bazua në disa veprimtari:

Veprimtari e parë ishte ajo kërkimore për botime, të dhëna statistikore me objekt lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, si dhe e identifikimin të legjislacionit vendas mbi këtë kategori të lirive të njeriut. Gjithashtu për të pasqyruar realitetin shqiptar puna kërkimore u bazuar në indentikimin dhe përzgjedhjen e ngjarjeve që kanë patur jehonë mediatiake në drejtim të ushtrimit të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar nga individë, organizime shoqërore dhe institucione fetare në Shqipëri.

Më tej, u vijua me përzgjedhjen e materialeve përkatëse studimore, akteve normative kombëtare dhe

ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, duke u fokusuar në thelbin e temës së Manualit. Pjesë e materialit teorik të prezantuar kryesisht në Pjesën e Parë dhe të Dytë të Manualit, është pasuruar me aktet normative evropiane dhe botërore, si dhe me informacion mbi mekanizmat që garantojnë mbrojtjen e këtyre lirive.

Në këtë punim, është përdorur edhe metoda e studimit të rastit, përmes të cilës janë shqyrtuar raste praktike nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe metoda e analizës, për të analizuar qasjen e kësaj gjykate lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Përmes metodës statistikore, janë grumbulluar statistika të ndryshme lidhur me numrin e rasteve në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të cilat kanë pasur si objekt shqyrtimi çështje nga liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Gjithashtu është përdorur metoda historike-juridike, me anë të cilës është shqyrtuar zhvillimi i lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në aspektin kohor. Si në çdo projekt afatshkurtër kufizimi metodologjik lidhur me përgatitjen e manualit ka të bëjë me fokusin vetëm në lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.



SHKURTIME

BE	Bashkimi Evropian
DUDNj	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, OKB, 1948
Gjk	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, KiE
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
KEDNj	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, KiE, 1950
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KP	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, OKB, 1966
Kushtetuta	Ligj nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
KMSh	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
KOASH	Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë
KBB	Kryegjyshata Botërore Bektashiane
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VUSh	Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë



HYRJE

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është një drejtë themelore e njeriut, e cila përveç se ka rëndësi të madhe për jetën e një individi, ka rëndësi gjithash-tu të jashtëzakonshme për shoqërinë në përgjithësi. Kjo e drejtë përfshin një gamë të gjerë të mendimeve dhe besimeve dhe në këtë mënyrë paraqet një burim të pluralizmit i cili është pjesë përbërëse e demokracisë.

Duke marrë parasysh se në mbarë botën është i pranishëm një diversitet i madh i mendimeve dhe besimeve fetare dhe jofetare, garantimi i lirisë së çdo feje dhe besimi përbën një sfidë për çdo shoqëri demokratike. Të gjitha fetë dhe besimet e ndryshme duhet të bashkëjetojnë të lira, ndaj edhe garantimi dhe mbrojtja e duhur për këto liri është nevojë e kohës për të shmangur konflikte që mund të lindin si pasojë e pranisë së shumëllojshmërisë në shoqëri.

Raportet dhe botimet zyrtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksojnë se kërkesat e parashtruara lidhur me shkeljet e supozuara të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, vështruar historikisht, janë në numër shumë të vogël në krahasim me kërkesat që parashtrohen për shkeljet e të drejtave të tjera, mirëpo në dy dekadat e fundit është shtuar dukshëm numri i kërkesave për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Besohet së në rritjen e këtyre kërkesave kanë ndikuar fërkimet e ndryshme mes sekularizmit dhe koncepteve fetare të cilat janë paraqitur në dekadat e fundit.

Duke patur parasysh sa më lart është e domosdoshme që jo vetëm të parashikohen dhe krijohen standarde, parime, institucione dhe mekanizma të caktuara në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të garantuara me lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, por gjithashtu të parashikohen edhe rastet e kufizimit të këtyre të drejtave kur është e domosdoshme të kufizohen dhe të përlligjen me akte normativet përkatëse. Standardet dhe parimet e tilla reflektohen në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si institucion i spikatur në interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

PJESA E PARË

PANORAMA NORMATIVE DHE INSTITUCIONALE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

Në këtë pjesë të parë, manuali parashtron një pasqyrë të rregullimit të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në disa nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare. Duhet theksuar që aktet e marra për shqyrtim nuk janë shterruese, kjo do të thotë se liria e mendimit, ndërgjegjes e fesë gjen rregullim edhe në akte të tjera ndërkombëtare, por për qëllime të këtij teksti është bërë një përzgjedhje e atyre akte, që janë vlerësuar më të rëndësishme për kontekstin shqiptar dhe audiencën e synuar.

Panorama e të drejtës ndërkombëtare mbi lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është ndarë në dy pjesë kryesore. Së pari, do të trajtohet kuadri rregullues i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë, në vazhdim të tij do të prezantohet kuadri evropian mbi këto liri.

STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË, SI DHE E KOMUNITETEVE FETARE

1.1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Në vitin 1948, Kombet e Bashkuara njohën rëndësinë e lirisë së fesë ose besimit në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut¹ (Deklarata Universale), i cili është dokumenti më i rëndësishëm në historinë moderne të zhvillimit të të drejtave të njeriut². Në nenin 18 të saj përcaktohet se *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo*

¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, OKB, 1948 <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights> [konsultuar më 10.08.2021]

² Akti i parë i miratuar në mbrojtje të të drejtave (politike) të njeriut, por vetëm me veprim në Britaninë e Madhe, konsiderohet Magna Carta Libertatum, firmosur nga Mbreti John më 15 qershor 1215. <https://www.britannica.com/topic/Magna-Carta> [konsultuar më 10 gusht 2021]

e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare. “

Deklarata Universale në përmbajtjen e saj, përcakton gjithashtu të drejtat për lirinë e bashkimit dhe mosdiskriminimin, që varen nga ligjet që ndikojnë në strukturimin e bashkësive fetare. Kështu, *“gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor” (neni 20)*. Për më tepër, *“secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket [...] besimit fetar” (neni 2)*, si dhe *“të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji.”(neni 7)*. Parimet e parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut kanë shërbyer si një bazë për një sërë instrumentesh ligjor ndërkombëtar e kombëtar që trajtojnë lirinë e mendimit, besimit dhe fesë. Megjithatë, vlen të theksohet se Deklarata nuk ka një karakter zbatueshmërie të detyrueshëm. Pra, mos respektimi i çdo parashikimi të saj nuk sjell sanksione të drejtpërdrejtë për shtetin përgjegjës.

1.2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është një akt i së drejtës ndërkombëtare publike i miratuar nga OKB në dhjetor 1966³ në vijim të parimeve të sanksionuara në Deklaratën Universale.

Pakti ka parashikuar dy mekanizma që sigurojnë zbatimin e të drejtave të parashikuara në të. Mekanizmi i parë janë raportet e detyrshme vjetore për zbatueshmerinë e tij, të cilat dorëzohen pranë Komitetit të të Drejtave të Njeriut. Ndërkohë, mekanizmi i dytë ka të bëjë me hetimet *ad hoc* në bazë të ankesave të individëve⁴.

Të drejtat civile dhe politike konsiderohen si kategoria më e rëndësishme e të drejtave themelore⁵, të cilat çdo individ duhet të gëzojë.

Në nenin 18 të tij Pakti parashikon se:

³ <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx> [konsultuar më 10.08.2021]

⁴ Peçi, I. & Xhepa, I. (2019). *E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi: manual*. Tiranë: QE & KAS, f. 62.

⁵ Mole, N. & L, V. (2018). *Drejt një zbatim efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: një guidë mbi parimet, konceptet kyçe të Konventës dhe përdorimi i tyre nga gjykatat vendase*. Beograd: AIRE Centre.

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit.
2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.
3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve.
4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Për një interpretim më të gjerë të nenit 18, në vijim të theksimit të rëndësisë së tij për sa i takon lirisë së fesë dhe besimit, ky manual, në vijim do të sjell në vëmend-

je Komentin e Përgjithshëm Nr. 22 (48)⁶ të hartuar në vitin 1993, nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, i cili siguron një interpretim të hollësishëm zyrtar të parashikimeve të paktit.

1.2.1 Kuptimi i lirisë së besimit dhe fesë sipas këtyre akteve ndërkombëtare

Komiteti për të Drejtat e Njeriut, i cili është organi përgjegjës për monitorimin e zbatueshmërisë së Paktit, në Komentin e Përgjithshëm⁷, që i bën nenit 18 të Paktit konstaton se ky nen mbron besimet teiste, jo-teiste dhe ateiste, si dhe të drejtën për të mos deklaruar asnjë fe apo besim⁸. Me qëllim për të krijuar një kuptim më të drejtë të nenit 18 është e nevojshme, që termat “besim” dhe “fe” të interpretohen pak më gjerësisht. Kështu, parashikimet e nenit 18 nuk janë të kufizuara vetëm për tu zbatuar për fetë tradicionale ose për fetë dhe besimet me karakteristika institucionale ose praktika analoge me ato të

⁶ UN Committee on the Rights of the Child (CRC), *General comment No. 20 (2016) on the implementation of the rights of the child during adolescence*, 6 December 2016, CRC/C/GC/20, available at: <https://www.refworld.org/docid/589dad3d4.html> [konsultuar më 8 nëntor 2021]

⁷ UN Human Rights Committee (HRC), *CCPR General Comment No. 22: Article 18 (Freedom of Thought, Conscience or Religion)*, 30 July 1993, CCPR/C/21/Rev.1/Add.4, available at: <https://www.refworld.org/docid/453883fb22.html> [konsultuar më 8 nëntor 2021]

⁸ Po aty.

feve tradicionale. Prandaj, Komiteti, interpretimin e të cilit do ta sjellim në vëmendje më gjërësisht në vijim, e sheh me shqetësim çdo tendencë për të diskriminuar çdo fe apo besim për çfarëdo arsye, përfshirë faktin se ato janë krijuar rishtas, ose përfaqësojnë pakica fetare që mund të jenë subjekt i armiqësisë nga ana e një komuniteti mbizotërues fetar⁹.

Në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, lira e fesë, ndërgjegjes dhe mendimit përfshin ‘adhurimin, respektimin, praktikimin dhe mësimin’ dhe mund të ushtrohet ‘individualisht ose në bashkësi me të tjerët, në publik ose privat’.¹⁰ Nga këndvështrimi thelbësor i këtij neni, liria për të manifestuar fenë ose besimin është homologia e jashtme (*forum externum*) e lirisë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose besim, i cili kuptohet si pjesë e sferës së brendshme të të menduarit dhe besimit të një personi (*forum internum*)¹¹. Kjo lidhje bëhet akoma më e rëndësishme kur bëhet fjalë për kufizimet. Aspekti thelbësor i lirisë së fesë ndërgjegjes dhe mendimit, e drejta që lidhet me as-

⁹ Po aty.

¹⁰ UN General Assembly, *International Covenant on Civil and Political Rights*, 16 December 1966, United Nations, Treaty Series, vol. 999, p. 171, available at: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b3aa0.html> [konsultuar më 8 nëntor 2021] article 18(1).

¹¹ UN Human Rights Council, *Report of the Special Rapporteur on freedom of religion or belief*, 23 December 2015, A/HRC/31/18, available at: <https://www.refworld.org/docid/56c2e4cd4.html> [konsultuar më 8 nëntor 2021]

pektin e brëndshëm apo të drejtën për tu qasur në një fe apo besim, nuk është objekt kufizimi. Ndërkohë, aspekti i jashtëm, i cili përkon me lirinë për ta manifestuar është objekt kufizimi në disa raste të caktuara¹².

1.2.2 Liria për t`u organizuar

Liria e besimit në mënyrë direkte mbulon të drejtën e individëve për tu mbledhur me të tjerët dhe për rrjedhojë garanton vendosjen në praktikë të lirisë së tyre të besimit në komunitet me të tjerët, qoftë privatisht qoftë publikisht. Ndonjëherë, lihet në harresë fakti që grupet fetare janë gjithashtu të mbrojtura nga dispozitat e nenit 22 të Paktit¹³, i cili adreson pikërisht, lirinë për t`u organizuar.

¹² UN Human Rights Committee (HRC), *CCPR General Comment No. 22: Article 18 (Freedom of Thought, Conscience or Religion)*, 30 July 1993, CCPR/C/21/Rev.1/Add.4, available at: <https://www.refworld.org/docid/453883fb22.html> [konsultuar më 8 nëntor 2021]

¹³ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 22 “1. *Secili person ka të drejtë të organizohet lirisht me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar sindikata dhe për të marrë pjesë në to për mbrojtjen e interesave të veta. 2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, qetësisë dhe rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizimet ligjore për ushtrimin e kësaj të drejte nga anëtarët e forcave të armatosura dhe të policisë. 3. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk i autorizon shtetet palë të Konventës së vitit 1948 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës lidhur me lirinë e organizimit dhe me mbrojtjen e së drejtës së organizimit për të marrë masa legjislative që mund të shkelin ose zbatojnë ligjin asisoj që cenojnë garancitë e parashikuara me Paktin e përmendur.”*

Ndërsa feja konsiderohet çështje shumë private për disa, duhet gjithësesi pranuar se shumica e feve nuk mund të praktikohen të izoluara, prandaj edhe konsiderohet i vlefshëm dhe i domosdoshëm parashikimi i nenit 22 i Paktit. Në kontekstin fetar, liria për t'u organizuar merr një dimension akoma më të rëndësishëm dhe meriton një mbrojtje akoma më të fortë duke qenë se organizimi në këtë kontekst vjen si rezultat i një lidhjeje të brendshme mbi baza besimi dhe praktikimesh fetare. Për sa i takon aspektit të manifestimit të besimit, vlen të theksohet që parashikohen disa kufizime por në çdo rast duhet të jenë konform ligjit, proporcionale dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike.

1.2.3 Mosdiskriminimi në bazë të fesë ose besimit

Parimi i mosdiskriminimit është universal dhe është integral për të gjitha të drejtat e njeriut, pavarësisht nëse janë civile, politike, ekonomike, sociale apo kulturore¹⁴. Ky parim natyrisht, që është i zbatueshëm edhe në lidhje me lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit. Në bazë të këtij parimi, shteteve u lind detyrimi për të vepruar në drejtim të zbatimit të tij duke mos lejuar aktorët shtetëror të diskriminojnë individë ose grupe individësh mbi baza feje ose

¹⁴ Peci, I. & Xhepa, I. (2019). *Cituar më lart*, f. 8.

besimi, por në të njëjtën kohë mbi shtetin rëndon edhe detyrimi i marrjes së masave të nevojshme pozitive për të parandaluar diskriminimin edhe nga aktorët jo-shtetërorë¹⁵. Pakti ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike riafirmon mbrojtjen e lirisë së fesë, ndërgjegjes dhe mendimit duke e bërë të qartë se shtetet janë të detyruara “të respektojnë dhe t’u sigurojnë të gjithë individëve brenda territorit dhe juridiksionit të tyre të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa asnjë dallim të çfarëdo lloji, të tillë si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose opinion tjetër, kombëtar ose origjina shoqërore, prona, lindja ose status tjetër”¹⁶. Për më tepër, Pakti detyron shtetet palë “të ndërmarrin hapat e nevojshëm ... për të miratuar masa të tilla legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për t’i dhënë efekt të drejtave të njohura në këtë Pakt”¹⁷ dhe për t’u siguruar që personat, të drejtat ose liritë e të cilëve shkelen do të kenë në dispozicion mjete juridike efektive për të rivendosur në vend të drejtën ose lirinë e shkelur.¹⁸

Rëndësinë e mosdiskriminimit e ka nënvizuar edhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, i cili në Komentin e tij të Përgjithshëm Nr.

¹⁵ Neni 2 i Paktit.

¹⁶ Neni 2, paragrafi 1 i Paktit.

¹⁷ Neni 2 paragrafi 2 i Paktit.

¹⁸ Neni 2 paragrafi 3 i Paktit.

18 (37),¹⁹ shprehet se: “*mosdiskriminimi, së bashku me barazinë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë të ligjit, përbëjnë një parim bazë dhe të përgjithshëm në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut*” dhe se pavarësisht se Pakti nuk bën një përcaktim të diskriminimit, ky term përdoret në përputhje me përdorimin e përgjithshëm, që gjen në të drejtën ndërkombëtare. Kështu, sipas mendimit të Komitetit, “*diskriminimi*” siç përdoret në Pakt nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që bazohet në çdo bazë të tillë si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, lindja ose status tjetër dhe ka qëllim ose efekt të anulojë ose dëmtojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga të gjithë personat, në mënyrë të barabartë, të të gjitha të drejtave dhe lirive²⁰. Më tej Komiteti vëren se, ndërsa neni 2 i Paktit e kufizon fushën e të drejtave që mbrohen nga diskriminimi, neni 26 nuk parashikon të tilla kufizime. Ky nen ndalon diskriminimin në çdo fushë të rregulluar dhe të mbrojtur nga autoritetet publike. Nga sa më sipër çdo ligj, që miratohet nga Shtetet Palë duhet të jetë komform kërkesave të imponuara nga përmbajtja e nenit 26.

¹⁹ UN Human Rights Committee (HRC), *CCPR General Comment No. 18: Non-discrimination*, 10 November 1989, available at: <https://www.refworld.org/docid/453883fa8.html>

²⁰ Po aty.

Në lidhje me trajtimin e diferencuar, Komiteti është shprehur se jo çdo diferencim në trajtim përbën diskriminim, nëse kriteret për një diferencim të tillë janë të arsyeshme dhe objektive, si dhe kanë pasur qëllim arritjen e një synimi legjitim.

Për sa i takon nenit 27, i cili siguron mbrojtje të veçantë kundër diskriminimit kur “ekzistojnë pakica etnike, fetare ose gjuhësore”²¹. Nuk ka një përcaktim të qartë në Pakt për sa i takon termit “pakicë”, por përgjithësisht ekziston tendenca për ti konsideruar pakicat si një grup kulturor të identifikueshëm, të lidhur së bashku nga gjuha e përbashkët, traditat, përkatësia etnike etj. Por që, nga përdorimi i fjalës “ose” në Pakt kuptojmë që mund të ketë pakica fetare që nuk janë domosdoshmërisht edhe pjesë e pakicave etnike ose gjuhësore²².

1.2.4 Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut – roli i tij në mbrojtje të lirisë së besimit dhe fesë

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut sikurse u theksua dhe më lart është një or-

²¹ Po aty.

²² Po aty.

gan i pavarur i përbërë nga 18 ekspertë, i cili monitoron zbatimin e Paktit²³.

Në vitin 1993, Komiteti miratoi Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 22 përmes të cilit siguron një interpretim të hollësishëm zyrtar të kuptimit të nenit 18 të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike²⁴. Komenti i Përgjithshëm trajton një numër të madh aspektesh të lirisë së fesë ose besimit, por ky modul do të sjelli në vëmendje vetëm disa që përkojnë me qëllimin e tij.

Komenti fillon duke vënë në dukje se liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është shumë e gjerë dhe e thellë. Karakteri themelor i këtyre lirive vërehet në faktin se ato nuk mund të kufizohen ose shfuqizohen as në kohë emergjencesh publike. Kufizimet në lirinë e fesë, ndërgjegjes dhe mendimit lejohen vetëm në lidhje me manifestimin e fesë dhe i kush-ton një vëmendje të veçantë arsytimit²⁵. Në këtë

²³ <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CCPR/Pages/CCPRIndex.aspx> [konsultuar më 05.09.2021].

²⁴ UN Human Rights Committee (HRC), *CCPR General Comment No. 22: Article 18 (Freedom of Thought, Conscience or Religion)*, 30 July 1993, CCPR/C/21/Rev.1/Add.4, available at: <https://www.refworld.org/docid/453883fb22.html>

²⁵ UN Human Rights Committee (HRC), *CCPR General Comment No. 22: Article 18 (Freedom of Thought, Conscience or Religion)*, 30 July 1993, CCPR/C/21/Rev.1/Add.4, available at: <https://www.refworld.org/docid/453883fb22.html>.

rast Komenti bën një dallim ndërmjet lirisë së mendimit, ndërgjegjës fesë ose besimit dhe lirisë për ta shfaqur fenë ose besimin. Askush nuk mund të detyrohet të shfaqë mendimet e tij ose respektimin e një feje ose besimi.

Komenti po ashtu përcakton se kufizimet që vendosen sa i përket këtyre lirive duhet të jenë të vendosura me ligj dhe nuk duhet të zbatohen në një mënyrë, që do të dëmtojë thelbin e të drejtave të garantuara në nenin 18. Komiteti kërkon që paragrafi 3 i nenit 18 të interpretohet në mënyrë rigoroze, ku kufizimet nuk lejohen të ndërmerren për asnjë arsye të tjerët që nuk është e përcaktuar në këtë nen. Kufizimet mund të aplikohen vetëm për ato qëllime për të cilat janë përshtuar dhe duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt dhe proporcionale me nevojën specifike mbi të cilën ato bazohen. Kufizimet nuk mund të vendosen për qëllime diskriminuese ose të zbatohen në mënyrë diskriminuese²⁶.

Sipas Komitetit, fakti se një shtet ka deklaruar një fe të caktuar si zyrtare, ose në ato raste kur një fe është tradicionalisht e përqafuar nga popullsia e shtetit, ose ndiqet nga pjesa më e madhe e popullsisë, nuk duhet të sjellë asnjë shkelje për gëzimin

²⁶ Po aty.

e të drejtave të garantuara nga neni 18 i Paktit për qytetarët e këtij shteti që nuk përqafojnë të njëjtën fe²⁷.

1.3 Deklarata mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi Bazë të Fesë ose Besimit

Deklarata mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi Bazë të Fesë ose Besimit²⁸ është instrumenti i parë ndërkombëtar në kategorinë “soft law”²⁹ që fokusohet në intolerancën fetare. Meqënëse ky akt i dedikohet specifikisht intolerancës dhe diskriminimit mbi baza feje ose besimi, ky manual do të paraqesë një përmbledhje të tekstit të kësaj Deklarate mbasi konsiderohet i rëndësishëm për qëllimin e tij.

Lidhjet midis Deklaratës së vitit 1981 dhe Paktit janë evidente. Neni 1 i Deklaratës së vitit 1981 thjesht përsërit fjalë për fjalë, gjuhën e tre paragrafëve të parë të nenit 18 të Paktit.

²⁷ Po aty.

²⁸ Deklarata mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi Bazë të Fesë ose Besimit miratuar më 25 nëntor 1981.

²⁹ Jo i detyrueshëm.

Neni 2, paragrafi 1, i kësaj Deklarate hedh dritë mbi mbajtësit e të drejtave dhe bartësit e detyrave duke theksuar se “*asnjë person nuk do të jetë subjekt i diskriminimit nga çdo shtet, institucion, grup personash ose person në bazë të të fesë apo besimit*”.³⁰ Formulimi “asnjë” nënkupton se të gjitha qeniet njerëzore (jo vetëm shtetasit), janë mbajtës të të drejtave dhe duhet të mbrohen, ndërsa si shtetet ashtu edhe aktorët jo-shtetërorë mund të jenë bartës të detyrës dhe autorë të mundshëm të diskriminimit në bazë ose në emër të fesë apo besimit.

Paragrafi 2 i nenit 2 përcakton “*intolerancën dhe diskriminimin e bazuar në fe ose besim*” si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë bazuar në fenë ose besimin dhe që ka për qëllim ose efektin e tij anulimin ose dëmtimin e njohjes, gëzimit ose ushtrimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në baza të barabarta³¹. Ky përkufizim është në përputhje me përkufizimin e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për sa i takon diskriminimit në Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 18.

³⁰ Deklarata mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi Bazë të Fesë ose Besimit miratuar më 25 nëntor 1981.

³¹ Po aty.

Në nenin 3 Deklarata thekson se “*diskriminimi midis qenieve njerëzore për shkak të fesë ose besimit përbën një fyerje ndaj dinjitetit njerëzor dhe mohim i parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe do të dënohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të shpallura në DUDNJ*³²”. Një formulim i fortë ky, i cili lidh pretendimet për trajtim jodiskriminues me respektimin e duhur të dinjitetit njerëzor të secilit.

Nëpërmjet nenit 4 të Deklaratës së vitit 1981 kërkohet që të gjitha shtetet “të marrin masa efektive për të parandaluar dhe eliminuar diskriminimin për shkak të fesë ose besimit në njohjen, ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në të gjitha fushat e civile, ekonomike, politike, sociale dhe jetën kulturore”. Ky mund të konsiderohet si një sqarim i rëndësishëm, duke pasur parasysh përpjekjet për kufizim në ushtrim të lirisë së fesë ose besimit, për shembull duke e vendosur kryesisht këtë të drejtë në “sferën private” ose duke spastruar institucionet publike ose kompani të caktuara nga manifestime të dukshme ose të dëgjueshme të fesë.

Neni 5 parashikon të drejta të hollësishme të prindërve dhe kujdestarëve ligjorë për të organizuar jetën brenda familjes në përputhje me fenë

³² Po aty.

ose besimin e tyre, duke iu referuar gjithashtu “interesave më të mirë të fëmijës” si parim udhëzues. Kjo dispozitë ruan parimin e “interesit më të lartë” dhe kërkon që pikëpamjeve të fëmijës t’i kushtohet pesha e duhur në përpunime me moshën dhe pjekurinë e fëmijës (neni 12 , paragrafi 1) dhe garanton shprehimisht të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 14, paragrafi 1).

Neni 6 përmban një listë jo shteruese të manifestimeve që mbrohen nën të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit. Formulimi i përdorur këtu përfshin liritë (a) për të ruajtur vendet për adhurim ose tubim; (b) për të krijuar institucione bamirëse ose humanitare; (c) për të bërë, blerë dhe përdorur materiale që lidhen me ritet ose zakonet; (d) për të shkruar, nxjerrë dhe shpërndarë botime; (e) për të mësuar një fe ose besim në vende të përshtatshme; (f) të kërkojë dhe të marrë kontribute vullnetare financiare dhe të tjera; (g) të trajtojë, emërojë, zgjedhë ose emërojë me radhë udhëheqës të përshtatshëm; (h) për të festuar festat dhe ceremonitë; dhe (i) të mbajë komunikim me individët dhe komunitetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Duke pasur parasysh faktin se në shumë kushtetuta kombëtare, dispozitat që lidhen me lirinë e fesë ose besimit përqendrohen kryesisht në elementin e

“adhurimit”, këmbëngulja për një kuptim të gjerë të manifestimeve rezulton shumë e rëndësishme³³.

Së fundi, neni 7 kërkon që legjislacionet kombëtare të sigurojnë që në praktikë të gjithë të jenë në gjendje të përfitojnë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Deklaratën e vitit 1981.

Si përfundim, Deklarata e vitit 1981 siguron udhëzime të rëndësishme për përcaktimin e kontureve të lirisë së fesë ose besimit, veçanërisht përmes katalogut jo shterues të manifestimeve të mbrojtura siç është renditur në nenin 6 të tij, i cili ka frymëzuar normat rajonale dhe kombëtare.

³³ Statuti i Këshillit të Evropës, <https://rm.coe.int/1680935bd0> [konsultuar më 09.11.2021]



GARANTIMI I LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË NË NIVEL RAJONAL – KËSHILLI I EVROPËS

2.1 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare me karakter rajonal e krijuar në 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe promovimit të demokracisë¹. Këshilli i Evropës është një organizatë tërësisht e ndryshme nga Bashkimi Evropian dhe numëron sot 47 Shtete Anëtare, mes të cilave dhe Shqipëria².

¹ <https://www.coe.int/en/web/about-us/who-we-are> [konsultuar më 30.09.2021]

² <https://www.coe.int/en/web/portal/47-members-states> [konsultuar më 30.09.2021]

Konventa Evropiane për Mrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim Konventa Evropiane ose KEDNJ) është miratuar në Romë më 4 nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në 1953. KEDNJ njihet si traktati më i rëndësishëm i Këshillit të Evropës³. Konventa parashikon një katalog të drejtash dhe lirish themelore, të cilat konsiderohen si kufiri minimal i të drejtave, që Shtetet Anëtare duhet të respektojnë. Konventa përbëhet nga neni 1, Seksioni I (nenet 2-18), Seksioni II (nenet 19-51) dhe Seksioni III (nenet 52-59) dhe shtatë Protokolle Shtesë⁴

Neni 1 i Konventës parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për respektimin e të drejtave të parashikuara më tej, jo vetëm në aspektin negativ (njohjen e të drejtave), por edhe në aspektin pozitiv (marrjen e masave për të mos ndërhyrë në këto të drejta)⁵.

Të drejtat e garantuara nga Konventa në Seksionin I të saj kategorizohen në:

³ <https://www.equalityhumanrights.com/en/what-european-convention-human-rights> [konsultuar më 30.09.2021]

⁴ https://www.echr.coe.int/Documents/Questions_Answers_ENG.pdf [konsultuar më 30.09.2021]

⁵ Harris, D. & O'Boyle, M. & Warbrik, (2014). *Law of the European Convention on Human Rights*. Oxford: Oxford University Press, p. 21-24.

- a. të drejta absolute, të cilat nuk mund të kufizohen asnjëherë– e drejta e jetës; ndalimi torturës; ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar; mos dënimi pa ligj; heqja e dënimit me vdekje; si dhe mos gjykimi ose dënimi dy herë;
- b. të drejta materiale, të cilat mund të kufizohen nëse ekziston një qëllim legjitim i parashikuar në mënyrë të qartë në nenin në fjalë, vendosur me ligj dhe proporcional – e drejta për jetë të qetë familjare dhe private, banesa dhe korrespondenca; liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë; liria e shprehjes; liria e tubimit dhe organizimit;
- c. të drejta të lidhura me administrimin e drejtësisë – e drejta për liri dhe siguri; e drejta për një proces të rregullt; e drejta për të apeluar çështje penale; mos gjykimi ose dënimi dy herë;
- d. të drejta të tjera që mund të kufizohen – e drejta për tu martuar; mbrojtja e pronës; e drejta për arsimim dhe e drejta për zgjedhje të lira⁶.

⁶ Mole, N. & Kamber, k. & Liaki, V. (2018). *Drejt një Zbatimi Efektiv në Nivel Kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Londër: AIRE Centre, f. 18-25.

Në varësi të kategorisë së cilës i përkasin të drejtat e garantuara nga KEDNJ varet dhe hapësira e vlerësimit, që shtetet gëzojnë në lidhje me kufizimin e këtyre të drejtave. Sikurse kuptohet nga ndarja e paraqitur më sipër të drejtat absolute nuk mund të kufizohen asnjëherë. Sa i përket të drejtave materiale ato mund të kufizohen vetëm për shkaqe të parashikuara nga vete nenet, që i garantojnë ato. Të drejtat e lidhura me administrimin e drejtësisë mund të kufizohen nga procedura të caktuara pa cenuar thelbin e tyre. Ndërkohë, për kategorinë të drejta të tjera shtetet gëzojnë një hapësirë më të gjerë vlerësimi.

Ndërkohë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është institucioni i vetëm përgjegjës për të siguruar zbatimin dhe interpretuar Konventën. Konventa ka një mekanizëm kontrolli të fortë, që garanton respektimin e të drejtave themelore për shtetet palë dhe individët.⁷

Ne për qëllime të këtij manuali, ne do të ndalemi në shpjegimin dhe analizimin e nenit 9 të KEDNJ vetëm dhe në lidhje me nene të tjera të Konventës, të cilat kanë qëllim kryesor garantimin e mëtejshëm të të lirive të nenit 9.

⁷ Harris, D. & O'Boyle, M. & Warbrik, *Cituar më lart*, p. 6.

2.1.1 Kuptimi i lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përbën një nga garancitë themelore të shoqërive demokratike, e për rrjedhojë ka gjetur pasqyrim dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pluralizmi i pashkëputur nga një shoqëri demokratike, që është fituar me kalimin e shekujve, varet nga ky dimension.⁸

Neni 9 i Konventës përmban dispozitën kryesore përmbajtësore të këtij traktati për sa i takon këtyre lirive. Përmbajtja e tij është në linjë të drejtë me përmbajtjen e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut hartuar para Koventës. Neni 9 i KEDNJ parashikon se:

1. *Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.*

⁸ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. (2015). *Udhëzues për nenin 9: liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë*. f. 17 https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_9_SQL.pdf [kosultuar më 01.10.2021]

2. *Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.*

Paragrafi i parë i nenit 9 ndjek nenin 18 të Deklaratës Universale fjalë për fjalë. Ndërkohë, paragrafi i dytë është praktikisht identik me klauzolën e kufizimeve të këtyre lirive parashikuar në nenin 18 të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike, përveç se kërkesa e domosdoshmërisë shtjellohet nga fraza “*në një shoqëri demokratike*”. Neni 9 i Konventës, në tërësinë e tij, përmban mbrojtjen për sistemin bazë të besimit të një individi dhe për të drejtën e manifestimit të besimit të tij si në mënyrë individuale, ashtu edhe me të tjerë, duke përfshirë këtu sferën private e publike.

Përveç nenit 9, Konventa Evropiane e garanton lirinë e fesë lidhur dhe me një të drejtë tjetër, konkretisht me të drejtën e prindërve për ti edukuar fëmijët e tyre sipas bindjeve filozofike dhe fetare, parashikuar në nenin 2 të Protokollit 1 të Konventës. Ndërkohë, që kjo liri sa i takon aspektit të jashtëm të saj, konkretisht në lidhje me shfaqjen e fesë dhe besim-

it, gjen garanci dhe në nenin 11 të Konventës – liria e tubimit dhe organizimit.

Në vijim do të ndalemi në analizimin e këtyre neneve, duke mbajtur në fokus të veçantë standardet e elaboruara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si institucioni i vetëm i legjitimuar për të interpretuar Konventë.

Jurisprudenca, në interpretimet që i bën këtij neni, qartëson faktin se autoriteteve shtetërore jo vetëm, që mund t'u kërkohet të distancohen nga ndërmarrja e hapave që mund të ndërhyjnë në mendim, ndërgjegje dhe fe, por në rrethana të caktuara ato kanë detyrimin për të ndërmarrë masa pozitive, që do të ushqejnë e mbrojnë këto të drejta⁹.

2.1.2 Interpretimi i Nenit 9 të KEDNj-së

Neni 9 i Konventës garanton një të drejtë klasike, të kombinuar me një të drejtë me karakter absolut¹⁰. Objekti i nenit 9 është tepër i gjerë pasi mbrohen opinionet dhe bindjet fetare, por këto të fundit nuk

⁹ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. (2015). *Udhëzues për nenin 9: liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë*. f. 17 https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_9_SQL.pdf [kosultuar më 01.10.2021]

¹⁰ Bianku, L. (2020). *Drejt praktikës: përdorimi i jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut në nivel vendas*. Tiranë: Qendra Europiane, f. 261.

kategorizohen domosdoshmërisht brenda fush-ëveprimit të këtij neni¹¹. Jo pa qëllim termi “fe” nuk është përkufizuar, pasi ajo çka mund të konsiderohet fe për dikë nuk është për dikë tjetër¹². Nocioni i “fesë”, që përfshihet në nenin 9 të Konventës rekomandohet të lexohet bashkërisht me nocionin “besim” - “feja ose besimi”.

Shprehja “*liria e fesë dhe besimit*” është përdorur në mënyrë gjithëpërfshirëse, për të treguar lirinë e besimeve teiste, jo-teiste dhe ateiste, si dhe lirinë për të mos ndjekur ndonjë nga këto besime¹³. Gjykata e Strasburgut ka një jurisprudencë të moderuar në lidhje me nenin 9, pasi ai nuk është përdorur në një numër të lartë kërkesash përpara saj¹⁴. Në jurisprudencën e nenit 9 të Konventës, GJEDNJ dhe ish Komisioni i të Drejtave të Njeriut¹⁵, janë trajtuar përgjithësisht çështjeve si liria e fesë në burgje, si dhe konfliktet midis respektimit të besimit dhe de-

¹¹ *Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, datë 29.04.2020, § 82.

¹² Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. (2015). *Cituar më lart*, f. 17]

¹³ Bahiyyih G. Tahzib. (1996). *Freedom of Religion or Belief: Ensuring Effective International Legal Protection*. The Hague: Kluwer Law International, 1996, fq. 3

¹⁴ 1009 kërkesa janë trajtuar nga Gjykata deri më 26.11.2021 <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22article%22:%5B%229%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D%7D>

¹⁵ Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut, shfuqizuar me Protokollin Nr. 11 të Konventës, më 1 nëntor 1998.

tyrave kontraktuale në punësim, si dhe çështjet e lidhura me kundërshtarët e ndërgjegjes.¹⁶

Teksti i Konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut nuk kanë bërë përkufizimi i nocioneve siç janë mendimi, ndërgjegjja dhe feja, por janë ndalur në dhënien e parimeve në lidhje me këto liri.

Mund të vërejmë se përgjatë viteve të fundit, janë shtuar çështjet e sjella përpara Gjykatës së Strasburgut, ku është kërkuar të trajtohet qëllimi dhe përmbajtja e nenit 9 në raste të ndryshme, që lidhen me: refuzimin për të dhënë autorizim për vendet e kultit apo regjistrimin e organeve fetare, si dhe ndalimi për të veshur simbole fetare në vende publike etj. Shumica e këtyre çështjeve kanë trajtuar më së shumti lirinë e fesë krahasimisht me lirinë e ndërgjegjes dhe të mendimit.

Gjykata në interpretimin e saj vlerëson se pluralizmi i fesë është i ndërtuar mbi njohjen e plotë dhe respektimin e diversitetit e dinamikës së traditave e identiteteve kulturore, etnike, besimeve fetare, artistike, letrare dhe ideve dhe koncepteve socio-ekonomike. Gjithashtu, konsiderohet tepër e rëndësishme bashkëveprimi harmonik i personave

¹⁶ Bianku, L. (2020), *Cituar më lart*, f.261-271.

dhe grupeve me identitete të ndryshme me qëllim arritjen e kohezionit social. Gjykata ka pranuar se diversiteti nuk duhet të perceptohet si kërcënim, por si një burim i pasur për një shoqëri demokratike.¹⁷

Krahas lirisë së fesë dhe besimit mbrohet edhe liria e ndërgjegjes. Në të njëjtën linjë me termat e trajtuara më sipër, Gjykata nuk ka dhënë ndonjë përkufizim se çka nënkuptojnë me “ndërgjegje” në kuadër të nenit 9 të Konventës. Megjithatë në jurisprudencën e saj GJEDNJ ka trajtuar raste¹⁸, që kanë të bëjnë pikërisht me ndërgjegjen. Në këto raste në përgjithësi individët konsiderohen si kundërshtarë për shkak të ndërgjegjes, një rast tipik ilustrues është kundërshtimi i shërbimit të detyruar ushtarak për shkak se nuk i përshtatet besimit apo ndërgjegjes së tyre.

Struktura e nenit 9 të Konventës, në mënyrë të ngjashme me DUDNJ dhe Paktin, tregon se këto liri kanë dy dimensione. Dimensioni i parë është aspekti apo sfera e brendshme (*forum internum*) e kësaj lirie, e cila është absolute dhe nuk mund të limitohet në asnjë lloj rrethane. Ndërkohë, i dyti është dimension i jashtëm (*forum externum*), e cila mund të jetë subjekt kufizimesh, që nuk duhet të

¹⁷ Po aty.

¹⁸ *Bayatyan k. Armenisë [DhM]*, nr. 23459/03, 7 korrik 2011, §§124 - 125.

tejkalojnë parashikimet e paragrafit të dytë të nenit 9. Liria fetare është kryesisht çështje e ndërgjegjes individuale, duke përfshirë lirinë e personit për të manifestuar ose jo fenë, vetëm dhe në privatësi, ose në shoqëri me të tjerët, në publik dhe brenda rrethit të atyre, që ndajnë të njëjtën fenenë me të. Neni 9 ka parashikuar disa forma të manifestimit të fesë, të cilat janë: adhurimi, mësimdhënia, praktikimi dhe respektimi.¹⁹ Gjykata iu është shmangur kërkesave ku duhet të vendoste në lidhje me aspekte teologjike²⁰. Gjithashtu, neni 9 ka garantuar të drejtën për të shfaqur ose jo besimin, e lidhur kjo me një aspekt negativ të lirisë fetare²¹.

Pra, paragrafi i parë i nenit 9 parashikon lirinë për të pasur e ndryshuar një fe ose besim në përgjithësi, e cila konsiderohet si një e drejtë absolute dhe nuk mund t'i nënshtrohet ndërhyrjes së shtetit²². Ndërkohë, paragrafi i dytë i këtij neni parashikon të drejtën për ta manifestuar fenë dhe besimin qoftë vetëm, ose në komunitet me të tjerët, në publik ose privatisht, për të manifestuar fenë ose besimin përmes adhurimit, mësimdhënies, praktikimit dhe respektimit.

¹⁹ *Kokkinakis k. Greqisë*, nr. 14307/88, 25 maj 1993, §31.

²⁰ Bianku, L. (2020), *Cituar më lart*, f. 263.

²¹ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. (2015). *Cituar më lart*, f. 19.

²² *Ivanova k. Bullgarisë*, nr. 10905/04

Pra, përpos aspekteve pozitive të së drejtës së besimit, neni 9 theksuam se mbron dhe anën tjetër të medaljes - mundësinë e individëve për të mos besuar e praktikuar besimin, si dhe për të mos vepruar në kundërshtim me ndërgjegjen e tyre²³.

2.1.3 Detyrimet pozitive dhe negative të shtetit

Konventa e më tej jurisprudenca e Gjykatës kanë elaboruar, përveç vetë aspektit pozitiv e negativ të vetë lirisë së fesë, detyrimet negative e pozitive edhe për Shtetet Palë për respektimin e kësaj të drejte.

Detyrimet pozitive, që shtetet duhet të ndërmarrin për të respektuar të drejtat e garantuara nga Konventa, parashikohen në nenin 1 të saj²⁴. Në kontesktin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, shtetet detyrohen të respektojnë dhe të sigurojnë për të gjithë individët, që i nënshtrohen juridiksionit të tyre pa diskriminim. Në kuadër të këtyre të drejtave, nëse detyra e shtetit në lidhje me aspektin negativ është të mos ndërhyjë në liritë e individit, në aspektin pozitiv shteti detyrohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i bërë të qënësishme këto të drejta. Megjithatë, shtetet gëzojnë një hapësirë vlerësimi me qëllim justifikimin e kufizimeve të ndërmarra nga to.

²³ Po aty, f. 19-23.

²⁴ Harris, D. & O'Boyle, M. & Warbrik, *Cituar më lart*, p. 21-24.

Ndërhyrjet në liritë e garantuara nga neni 9 i Konventës janë të justifikuara vetëm në ato raste kur vendoset në rrezik siguria publike, rendi, shëndeti dhe mora ose mbrojtja e të drejtëve të tjerëve²⁵. Kufizimet në lidhje me sigurinë kombëtare, të cilat hasen në paragrafet e dyta të të drejtave të tjera materiale të garantuara nga Konventa (e drejta për jetë të qetë private dhe familjare, liria e shprehjes, si dhe liria e tubimit e organizimit), nuk është përfshirë në mënyrë të qëllimshme, duke theksuar rëndësinë e pluralizmit fetar²⁶.

Pikërisht, garancia e paragrafit të dytë të nenit 9 nuk është absolute, por sikurse u theksua më lart, mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara në këtë paragraf. Kjo garanci kërkon, që ndërhyrja të jetë legjitime, të përmbushë një nevojë të ngutshme shoqërore, duke respektuar në të gjitha rastet parimin e proporcionalitetit kundrejt qëllimit legjitim të ndjekur. Sipas Gjykatës, duhet të ketë një lidhje të arsyeshme midis qëllimit të kufizimit dhe mjeteve të përdorura për të arritur atë.²⁷

Në Gjykatën e Strasburgut shumica e çështjeve të trajtuara në lidhje me nenin 9 të KEDNJ kanë të

²⁵ S.A.S. k. Francës [DhM], nr. 43835/11, 01.07.2014.

²⁶ Po aty, f. 14 https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_9_SQL.pdf [kosultuar më 01.10.2021]

²⁷ *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5493/72, 7 dhjetor 1976, § 49.

bëjnë me ndërhyrjet e autoriteteve të shtetit në liritë e individit për të manifestuar lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Duke ju referuar intepretimeve, që ka bërë Gjykata në lidhje me këto vendime, vërejmë se, përveç rasteve të manifestimit të fesë, janë trajtuar edhe raste të besimeve apo bindjeve, që nuk kanë karakter fetar të tilla si pacifizmi ateizmi etj. Për t'u konsideruar si "manifestim" në kuptim të nenit 9, një veprim duhet të jetë i lidhur ngushtë me një fe ose besim. Një shembull i tillë mund të jetë një veprim i adhurimit ose devotshmërisë, i cili përbën një pjesë të praktikimit të një feje ose besimi në një mënyrë të njohur përgjithësisht. Megjithatë, manifestimi i fesë, ose besimit nuk kufizohet në akte të tilla; ekzistenca e lidhjes së direkte mes veprimtimit dhe besimit duhet të përcaktohet në çdo rast konkret²⁸.

Një rast interesant sa i takon kufizimit të të drejtave të nenit 9, në lidhje me aspektin e jashtëm të këtyre lirive, manifestimi i fesë në publik, e kemi ndeshur dhe gjatë periudhës së pandemisë shkaktuar nga COVID-19. Konkretisht, karantina e përgjithshme detyroi institucionet fetare të mbylleshin, duke sjellë kështu dhe organizimin e ceremonive zyrtare për festat fetare pa praninë e besimtarëve.

²⁸ Kalik k. Turqisë, nr. 1743/10

2.1.4 Mosdiskriminimi në bazë të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Parimi i mos diskriminimit, si një ndër parimet bazë të të gjithë akteve ndërkombëtare me rëndësi thelbësore në fushën e të drejtave të njeriut, përshkon edhe Konventën Evropiane duke vendosur disa detyrime pozitive për shtetin. Madje detyrimet e shtetit ka raste, që dalin dhe jashtë kufinjve territorial, në ato situata kur shteti deklaron se ai është përgjegjës dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të një shteti tjetër²⁹.

Kydetyrim pozitiv është përforcuar akoma më shumë nga përmbajtja e nenit 14 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të saj. Jurisprudenca e GJEDNJ e ka interpretuar në mënyrë të vazhdueshme nocionin e diskriminimit, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Si diskriminim të drejtpërdrejtë, Gjykata konsideron rastet e trajtimit të ndryshëm pa ndonjë qëllim dhe justifikim të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme, si dhe dëshimin për të trajtuar në mënyrë të ndryshme personat në situata dukshëm të ndryshme³⁰. Vlen për tu sjellë në vëmendje se sidoqoftë në të tilla situata

²⁹ Mole, N. & Kamber, K. & Liaki, V., *Cituar më lart*, f. 12.

³⁰ Peçi, I. & Xhepa, I., *Cituar më lart*, f. 62

shtetet gëzojnë një farë “hapësire vlerësimi” për të përcaktuar nëse dhe deri në çfarë mase dallimet në situata të tjera të ngjashme justifikojnë trajtim të ndryshëm.³¹

Për sa i takon diskriminimit të tërthortë konsideron ato raste ku një politikë e përgjithshme, ose një masë e cila në mënyrë joproporcionale ka efekte paragjyquese në një grup të caktuar mund të konsiderohet diskriminuese pa marrë parasysh nëse nuk është e drejtuar në mënyrë specifike në atë grup madje edhe nëse nuk ka qëllim diskriminues³². Sidoqoftë, në çështjen *Manoussakis e të Tjerë k. Greqisë*³³, Gjykata e ka bërë të qartë se në përcaktimin e hapësirës së vlerësimit, që vlen për çështjet e lirisë fetare, shtetet duhet të shqyrtojnë me kujdes se çfarë vihet në rrezik në rast kufizimi. Përkatësisht nevojën për të siguruar pluralizmin e vërtetë fetar, një tipar i qenësishëm i nocionit të një shoqëri demokratike.

³¹ *Willis k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, 11 qershor 2002, § 39.

³² Peçi, I. & Xhepa, I., *Cituar më lart*, f. 62

³³ *Manoussakis dhe të Tjerët k. Greqisë*, nr. 18748/91, 26.09.1996, § 41.

2.1.5 Lidhja e nenit 9 të Konventës me lirinë e tubimit dhe organizimit

Sikurse e përmendëm dhe më lart, liria e fesë, kryqëzohet edhe me të drejta të tjera të njeriut, përfshirë të drejtat për lirinë e shprehjes, lirinë e tubimit etj. Në këtë moment do të ndalemi në ndërlidhjen e lirisë së fesë me garancitë e nenit 11 të Konventës – Liria e tubimit dhe organizimit³⁴.

Nga përmbajtja e nenit 11 rezulton, që nëpërmjet tij garantohen dy të drejta për të vepruar në mënyrë kolektive me të tjerët. Konkretisht, liria e tubimit, e cila përfshin mbledhjet publike dhe private, marshimet, procesionet, demonstratat dhe protestat ku protestuesit refuzojnë të largohen derisa të jenë plotësuar kërkesat e tyre. Qëllimi mund të jetë politik, fetar ose shpirtëror, ose çdo qëllim tjetër; lidhur me qëllimin nuk është vënë asnjë kufizim, por çdo tubim duhet të jetë paqësor³⁵. Dhuna e rastësishme nuk do të thotë që tubimi e humbet mbrotjen, në përjashtim të rasteve kur ai ka qëllim përçarës. Nga

³⁴ Një sqarim i detajuar mbi të drejtat e garantuara nga neni 11 KEDNJ është bërë dhe në manualin botuar nga Qendra Europiane dhe KAS Programi për Shtetin e së Drejtës – Liria e tubimit dhe organizimi: manual – I. Petrela & I. Xhepa (2020).

³⁵ Petrela, I. & Xhepa, I. (2020). *Liria e tubimit dhe organizimi: manual*. Tiranë: Qendra Europiane & KAS RoLSEE, f. 14-15.

ana tjetër, liria e organizimit është e drejta për t'u organizuar me të tjerë për të formuar organe për të ndjekur objektiva të përbashkëta kolektivisht. Ajo përfshin specifikisht të drejtën për të formuar sindikatat për mbrojtjen e interesave të anëtarëve. Ashtu si dhe sindikatat, dy lloje organizimesh me rëndësi të veçantë janë partitë politike dhe organet fetare³⁶.

Sa i takon ndërlidhjes së lirisë së fesë me të drejtat e neni 11 të Konventës, drejta për të shfaqur fenë e dikujt dhe për të qenë i lirë nga diskriminimi mbi baza fetare mund të vijë gjithashtu në konflikt të dukshëm me të drejtën për lirinë e tubimit. Në të njëjtën kohë, këto të drejta mund të ndërthuren në mënyrë plotësuese dhe përforcuese reciproke; për shembull, një individ që shfaq fenë ose besimin e tij mund të mbrohet si nga liria e fesë ashtu edhe nga liria e shprehjes dhe/ose liria e tubimit.

Në rastet kur janë hasur pretendime për shkelje të më shumë se një prej këtyre të drejtave, Gjykata përpiket ta zgjidhë çështjen duke marrë parasysh nenin më të rëndësishëm për rrethanat e ngjarjes por në çdo rast duke pasur parasysh në interpre-

³⁶ Po aty.

tim edhe parashikimet e nenit tjetër në respekt të parimit të proporcionalitetit.

Në vijim do të bëjmë një përmbledhje të disa çështjeve të rëndësishme, të trajtuara nga Gjykata në lidhje me nenin 9 dhe ndërlidhje me të drejta të tjera të Konventës.

2.2 Praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut

Ruajtja e natyrës laike të institucioneve të arsimit tëlartë nuk përbën shkelje të së drejtës për t'u arsimuar

LEYLA SAHIN k. TURQISË

(kërkesa nr. 44774/98)

10 nëntor 2005

FAKTET KRYESORE Në 23 shkurt 1998, Zëvendëskancelari i Universitetit të Stambollit publikoi një rregullore, e cila ndalonte studentët e mbuluar me shami të stilit islamik që të pranoheshin në leksione, kurse apo konsultime. Gjatë kohës që ishte në fuqi kjo rregullore, znj. Leyla Sahin studionte pranë Fakultetit të Mjekësisë në këtë universitet. Në mars të vitit 1998, ajo u ndalua që të merrte pjesë në një provim me shkrim, për shkak se kishte vendosur një shami të stilit islamik. Rrjedhimisht, duke

përdorur të njëjtën logjikë, autoritetet e universitetit refuzuan të regjistronin znj. Sahin në lëndë dhe provime të ndryshme me shkrim. Gjithashtu, fakulteti i dërgoi asaj një paralajmërim për thyerje të rregullore së kodit të veshjes, si dhe e përjashtoi për një semestër për shkak të pjesëmarrjes së organizuar nga studentët kundër kësaj rregulloreje. Pas rrëzimit të çështjes nga gjykatat administrative, të cilat arsyetuan se një zëvendëskancelar në universitet ka të drejtë të vendosë rregullore të tilla, edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë Administrative u shprehën se rregullorja nuk është e jashtligjshme. Më pas, znj. Sahin vendosi të bazojë kërkesën e saj në nenin 2 të Protokollit nr. 1.

VENDIMI Në lidhje me nenin 9, Dhoma e Madhe vazhdoi arsyetimin se rregullorja në fjalë, e cila ndalonte kërkuesen të mbante shaminë islame në ambientet e universitetit, cenonte të drejtën e saj për të manifestuar besimin fetar. Megjithatë, liria e veshjes në universitet si një institucion i arsimit të lartë, nuk është absolute. Rregulloret për veshjen e shallit islamik kishin ekzistuar në Universitetin e Stambollit që prej vitit 1994, përpara se kërkuesja të hynte në universitet. Në këto kushte, Gjykata gjeti një bazë ligjore për ndërhyrje në ligjin turk dhe kërkuesja duhet ta kishte të qartë që në momentin që hyri në universitet, se do të kishte kufizime

për veshjen e shallit islamik dhe, që nga data kur rregullorja hyri në fuqi në 1998, asaj do ti ndalohej aksesimi në leksione dhe provime, nëse do të mban-te shallin. Gjykata vlerësoi se kjo ndërhyrje ndiqet qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së rendit publik. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, liria për të manifestuar fenë e dikujt mund të kufizohet për të mbrojtur vlerat dhe parimet demokratike. Dhoma e Madhe konsideroi se nocioni i sekularizmit ishte në përputhje me vlerat që mbështesin Konventën. Ruajtja e këtij parimi konsiderohet e nevojshme për të mbrojtur sistemin demokratik në Turqi. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 9.

Sa i përket nenit 2 të Protokollit nr. 1, Gjykata arsyetoi se, nëse shamia e stilit islamik lejohet në ciklet e para dhe të dyta të arsimit, atëherë është e vështirë të mendohet se institucionet e arsimit të lartë nuk respektojnë të njëjtën logjikë. Sidomos në një shoqëri demokratike, ku e drejta për arsim përbën një përparim të pazëvendësueshëm për të drejtat e njeriut, neni 2 i Protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet me kufizime të paragrafit të parë të tij, sa i takon arsimit të lartë. Rrjedhimisht, institucionet ekzistuese të arsimit të lartë në atë kohë ishin në logjikë të drejtë të fjalisë së parë të nenit 2 të Protokollit nr. 1.

Sa i përket neneve 8, 10 dhe 14, rregullorja nuk kishte për qëllim të kundërshtonte përkatësinë fetare të palës paditëse, por për të vendosur rregull dhe garantuar të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe synonte të ruante natyrën laike të institucioneve arsimore. Lidhur me sa më sipër, Gjykata vendosi se ndër të tjera, nuk kishte asnjë shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1, referuar fjalisë së tij të parë.

* * *

Dëbim dhe refuzim i pajustificuar për riregjistrimin e Komunitetit fetar të Dëshmitarëve të Jehovait të Moskës

DËSHMITARËT E JEHOVAIT TË MOSKËS DHE TË

TJERË K. RUSISË

(kërkesa nr. 302/02)

10 qershor 2010

FAKTET KRYESORE Kërkuesit janë komuniteti fetar i Dëshmitarëve të Jehovait të Moskës (“komuniteti aplikant”), i krijuar në vitin 1992, dhe katër individë që janë anëtarë të këtij komuniteti dhe jetojnë në Moskë. Dëshmitarët e Jehovait janë të pranishëm në Rusi që nga viti 1891. Ata u dëbuan pas Revolucionit Rus në 1917 dhe u persekutuan në Bashkimin Sovjetik. Pas miratimit të ligjit të vitit 1990 për lirinë e ndërgjegjes dhe

organizatat fetare, komuniteti kërkues, mori statusin e personit juridik në dhjetor 1993 nga Departamenti i Drejtësisë së Qytetit të Moskës. Nga viti 1995, një organizatë joqeveritare e lidhur me Kishën Ortodokse Ruse, e quajtur “Komiteti i Shpëtimit” u ankua pesë herë për menaxhimin e komunitetit kërkues përpara zyrës së prokurorisë së rrethit. Si rezultat, u hapën hetimet penale dhe më pas u ndërpre në me rekomandimin e një hetuesi për të ngritur një padi civile kundër komunitetit kërkues duke kërkuar shpërbërjen e tij dhe ndalimin e aktiviteteve të tij, padi e cila u ngrit në prill 1998. Gjykata përkatëse e rrethit, i gjeti ankesat të pabazuara. Pas ankimimit të prokurorit, çështja u kthye për shqyrtim të ri nga tjetër trup gjykues. Ndërkohë, një ligj i ri për lirinë e ndërgjegjes dhe shoqatat fetare (“Akti Fetar”) hyri në fuqi në tetor 1997. Sipas tij, të gjitha shoqatat fetare të cilave më parë iu ishte dhënë statusi i entitetit ligjor, duhet të përputhnin statutet e tyre me atë akt dhe të reregjistrohen nga departamenti kompetent i drejtësisë. Midis 20 tetorit 1999 dhe 12 janarit 2001, komuniteti kërkues aplikoi për reregjistrim pesë herë, por pa sukses. Në gusht 2002, gjykata kompetente vendase vendosi se refuzimet e Departamentit të Drejtësisë në Moskë ishin të paligjshme, por nuk urdhëroi reregjistrimin duke u shprehur se forma e dokumenteve të aplikimit kishite ndryshuar dhe kërkuesit duhet të riaplikonin. Një raund i ri i proceseve civile të vitit 1998 kundër komunitetit kërkues përfundoi në mars 2004

me një vendim gjykate që urdhëronte shpërbërjen e tij dhe vendosjen e një ndalimi të përhershëm për aktivitetet e tij. Gjykata e shpalli komunitetin kërkues përgjegjës, ndër të tjera, për joshjen e të miturve në shoqata fetare kundër vullnetit të tyre dhe pa pëlqimin e prindërve të tyre; detyrimin e besimtarëve për të shkatërruar familjen; cenimin e personalitetit, të drejtave dhe lirive të qytetarëve, duke shkaktuar dëme në shëndetin e qytetarëve; nxitjen e vetëvrasjes ose refuzimin për arsye fetare të ndihmës mjekësore për personat në rrezik për jetën ose shëndetin; dhe nxitjen e qytetarëve që të refuzojnë të përmbushin detyrat e tyre civile. Komuniteti u ankua për shkelje të nenit 9 dhe nenit 11.

VENDIMI I GJYKATËS Në lidhje me nenin 9, Gjykata kujtoi praktikën e saj, në të cilën ishte shprehur se liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, janë themelet për një shoqëri demokratike. Ai ishte gjithashtu një nga elementët më vitalë për identitetin e besimtarëve, por edhe një pasuri e çmuar për ateistët, agnostikët, skeptikët dhe ata që nuk shqetësohen. Prej tij varej pluralizmi, i fituar shumë gjatë shekujve dhe i pandarë nga një shoqëri demokratike. Vendimi i gjykatave ruse për të shpërndarë komunitetin kërkues dhe për të ndaluar aktivitetet e tij, kishte rezultuar në pamundësinë e tij për të ushtruar të drejtën për të zotëruar ose marrë me qira pronë, për të mbajtur llogari bankare, për të punësuar punonjës dhe për të siguruar mbrojtjen gjyqësore

të komunitetit, anëtarëve dhe aseteve të tij. Ai vendim ishte bazuar në Aktin Fetar dhe kishte ndjekur qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit dhe të të drejtave të të tjerëve në përputhje me nenet 9 dhe 11. Megjithatë, Gjykata konstatoi se vendimi për shpërbërjen e komunitetit kërkues nuk ishte mbështetur në një bazë faktike. Gjykatat vendase nuk kishin paraqitur arsye relevante dhe të mjaftueshme për të treguar se komuniteti kërkues kishte detyruar familjet të ndaheshin, se kishte shkelur të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tij ose palëve të treta, se kishte nxitur ndjekësit e tij të kryenin vetëvrasje ose refuzonte kujdesin mjekësor, etj. Kufizimet e vendosura nga komuniteti kërkues për anëtarët e tij, si pritshmëria për t'u lutur, predikimi derë më derë dhe rregullimi i aktiviteteve të tyre të kohës së lirë, nuk kishin ndryshime thelbësore nga kufizimet e vendosura nga fetë e tjera në jetën private të pasuesve të tyre. Për më tepër, konkluzioni i gjykatave vendase se shtrëngimi ishte përdorur për të detyruar anëtarët t'i bashkoheshin komunitetit ishte bërë pa asnjë provë për këtë. Kështu, shpërbërja e komunitetit kishte qenë një sanksion tepër i rëndë dhe joproporcional në krahasim me qëllimin legjitim të ndjekur nga autoritetet. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 9 të Konventës, marrë së bashku me nenin 11.

Gjykata arriti në përfundimin se, duke mohuar reregjistrimin për Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës,

autoritetet e Moskës nuk kishin vepruar me mirëbesim dhe kishin neglizhuar detyrën e tyre të neutralitetit dhe paanshmërisë ndaj komunitetit kërkues. Prandaj, kishte pasur një shkelje të nenit 11 të Konventës, marrë së bashku me nenin 9.

Lidhur me nenin 41, Gjykata vendosi se Rusia duhej t'u paguante kërkuesve bashkërisht 20,000 euro si dëm jomonetar dhe 50,000 euro për kostot dhe shpenzimet.

* * *

Në lidhje me dënimin e Dëshmitarëve të Jehovait për krijimin e një vendi kulti pa autorizim paraprak administrativ

MANOUSSAKIS DHE TË TJERË K. GREQISË

(kërkesa nr. 18748/91)

26.09.1996

FAKTET KRYESORE Kërkuesit janë të gjithë Dëshmitarë të Jehovait që jetojnë në Kretë. Në 30 mars 1983, z. Manoussakis lidhi një kontratë qiraje për një ambient 88 m² në rrethin Heraklion, Ghazi, ku specifikisht përcaktohej se do të përdorej për të gjitha llojet e takimeve, dasmave, etj., të komunitetit. Një sërë incidentesh patën ndodhur ndaj objektit, të cilat kërkuesi i kishte denoncuar në rajonin e policisë. Me një kërkesë të datës 28 qershor 1983, të paraqitur pranë Ministrit të Arsim-

it dhe Çështjeve Fetare, kërkuesit kërkuan një autorizim për ta përdorur dhomën si vend kulturi. Në të njëjtën ditë ata shkuan te kryetari i Këshillit të Qarkut Ghazi për t'i kërkuar atij që të vërtetonte nënshkrimet e tyre në aplikim. Ai refuzoi, me arsyetimin se kërkuesit nuk banonin në rrethin e tij dhe se ata nuk i kishin treguar atij dokumentin që mbante nënshkrimet e tyre. Pas ndërhyrjes së prefektit të Heraklionit, zëvendësministrit të Brendshëm dhe Kryetarit të Kuvendit të Greqisë, kryetari tërhoqi kundërshtimin dhe pranoi të vërtetonte nënshkrimet në një kërkesë të re të paraqitur më 18 tetor 1983. Më 30 korrik 1983, Kisha e Famullisë Ortodokse Ghazi njoftoi autoritetet e policisë së Heraklionit se dhoma po përdorej si një vend kulturi i paautorizuar për Dëshmitarët e Jehovait dhe i informoi ata për kërkesat e bëra nga kërkuesit te Ministri. Autoritetet kishtarë i kërkuan policisë që të kryejë një inspektim të ambienteve, të marrë masa ndëshkuese ndaj përgjegjësve dhe mbi të gjitha të ndalojë çdo takim të mëtejshëm derisa ministri të ketë dhënë autorizimin në fjalë. Më 3 mars 1986, prokuroria publike e Heraklion filloi procedimin penal kundër kërkuesve sipas legjislacionit të brendshëm. Në veçanti, ata u akuzuan se kishin “krijuar dhe bërë funksional një vend klishe për mbledhjet dhe ceremonitë fetare të Dëshmitarëve të Jehovait pa autorizim nga autoritetet e njohura kishtarë dhe Ministri i Arsimit dhe Çështjet Fetare”. Gjykata e shkallës së parë u shpreh se praktikuesit e secilit besim janë të

lirë të mblidhen dhe të predikojnë fenë e tyre, pa qenë nevoja për të pasur ndonjë autorizim. Pas apelimit nga Zyra e Prokurorit, Gjykata e Apelit i dënoi kërkuesit me tre muaj burgim të konvertueshëm në një gjobë prej 400 dhrahmi në ditë paraburgim, dhe i dënoi ata me 20,000 gjobë dhrahmi secila. Apelimi i kërkuesve ndaj këtij vendimi u hodh poshtë nga Gjykata e Kasacionit më 19 mars 1991. Kërkuesit pretenduan për shkelje të nenit 9 të Konventës.

VENDIMI I GJYKATËS Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 9, Gjykata u shpreh se dënimi i dhënë nga Gjykata Penale e Heraklionit, me pretendimin se kërkuesit nuk duhet të kishin vazhduar praktikimin e fesë së tyre në ambientin e marrë me qira, në mungesë të autorizimit, përbënte në fakt një shkelje të lirisë së fesë. Në lidhje me dhënien e një autorizimi, sipas legjislacionit të brendshëm, qeveria ka të drejtën të japë ose të refuzojë një autorizim, ose të qëndrojë e heshtur për këtë, pa kufizim në kohë apo ndonjë kriter tjetër substancial. Ligji që e bën praktikimin e besimit fetar të lidhur me marrjen e një autorizimi, nuk mund të perceptohet si një ligj që respekton lirinë e fesë, përkundrazi, e kufizon dhe cenon atë. Edhe Gjykata, ashtu si kërkuesit, pohoi se shteti grek kishte të drejtën të kontrollonte veprimtarinë e komuniteteve të ndryshme fetare, me qëllimin legjitim të ruajtjes së qetësisë dhe rendit publik. Duke pasur

parasysh rrethanat e çështjes dhe duke pasur të njëjtin këndvështrim si Komisioni, Gjykata vlerëson se masa e kundërshtuar ndoqi një qëllim legjitim për qëllimet e nenit 9 par. 2 të Konventës, përkatësisht mbrojtjen e rendit publik. E drejta për lirinë e fesë, siç garantohet me Konventë, përjashton çdo diskrecion nga ana e shtetit për të përcaktuar nëse besimet fetare ose mjetet e përdorura për të shprehur besime të tilla, janë legjitime. Prandaj, Gjykata vlerësoi se kërkesa për autorizim sipas ligjit nr. 1363/1938 dhe dekreti i 20 majit/2 qershorit 1939 ishin në përputhje me nenin 9 të Konventës, vetëm për atë sa synohet të lejojë Ministrin të verifikojë nëse kushtet formale të përcaktuara në ato akte janë përmbushur.

Në rastin konkret, kërkuessit u ndoqën penalisht dhe u dënuan pasi kishin operuar një vend kulti pa marrë më parë autorizimet e kërkuara me ligj. Në memorialin e tyre, qeveria pohoi se sipas nenit 1 të dekretit të 20 majit/2 qershorit 1939, një autorizim nga peshkopi vendas ishte i nevojshëm vetëm për ndërtimin dhe funksionimin e një kisha dhe jo për një vend kulti si në rastin konkret. Mjafton një kërkesë drejtuar Ministrisë të Arsimit dhe Çështjeve Fetare, siç në fakt ishte paraqitur nga kërkuessit. Në këto rrethana, Gjykata vlerësoi se Qeveria nuk mund të mbështetej në dështimin e kërkuessve për të përmbushur një formalitet ligjor për të justifikuar

dënimin e tyre. Ashtu si Komisioni, Gjykata është e mendimit se dënimi i kundërshtuar kishte një efekt kaq të drejtpërdrejtë në lirinë e besimit të kërkuesve, sa që nuk mund të konsiderohej si proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur dhe, në përputhje me rrethanat, si i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Si përfundim, kishte pasur shkelje të nenit 9.

* * *

S.A.S k. FRANCËS

(*kërkesa nr. 43835/11*)

1 korrik 2014

FAKTET KRYESORE Kërkuesja është një shtetase franceze, lindur në vitin 1990 dhe banuese në Francë. Ajo është një myslimane e devotshme, që mban burka dhe hixhab në përputhje me besimin, kulturën dhe bindjet e saj të brendshme. Kërkuesja nuk e mbante veshjen myslimane në çdo moment, ajo ndonjëherë dilte dhe në vende publike pa e veshur burkën dhe hixhabim. Ajo është shprehur se donte të ishte e lirë t'i vishte ato sa herë dëshironte, si psh., gjatë muajit të Ramazanit, për të shprehur besimin e saj dhe jo për të shkaktuar pakënaqësi apo provokim tek të tjerët. Ajo nuk bënte rezistencë kur i kërkohet që të ngrinte hixhabin për t'u identifikuar në pikat e sigurisë në aeroporte apo në banka. Në 11 prill 2011, hyri në fuqi

ligji nr. 2010-1192 që ndalonte mbulimin e fytyrës në vendet publike. Kërkuesja pretendoi për shkelje të nenit 8, 9 dhe 14 të Konventës.

VENDIMI I GJYKATËS Në lidhje me pretendimin se ka pasur shkelje të nenit 8 dhe 9 të Konventës, Gjykata vërejtë se për shkak të ligjit të ri në fuqi, kërkuesja ose do të bindej, e do ndalohej të vishej në përputhje me besimin e saj fetar, ose do të kundërshtonte të bindet dhe do të përballej me sanksione penale. Gjykata është e mendimit se zgjedhjet personale për sa i përket paraqitjes së dëshiruar të një individi, qoftë në vende publike apo private, lidhen me shprehjen e personalitetit të tij/saj dhe për rrjedhojë, përfshihen në nocionin e jetës private. Qeveria argumentoi, nga ana e saj, se ligji ndoqi dy qëllime legjitime: sigurinë publike dhe “respektimin e grupit minimal të vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike”. Gjykata vëren se paragrafët e dytë të neneve 8 dhe 9 nuk i referohen shprehimisht synimit të dytë ose tre vlerave të përmendura nga Qeveria në lidhje me këtë. Ndrkohë, ajo vlerësoi se ligji për ndalimin e veshjeve që mbulonin fytyrën në ambientet publike, ishte në linjë me kërkesën për të ruajtur sigurinë publike. Lidhur me nenin 9, liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, Gjykata e shqyrtoi çështjen duke vlerësuar nëse masat e marra ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, përfshin

një sërë lirish dhe të drejtash, duke përfshirë këtu lirinë për të patur ose jo një besim fetar, për ta praktikuar ose jo atë, për ta manifestuar, vetëm ose me të tjerët, privatisht ose në publik, për të dhënë mësimë feje apo për t'u falur, etj. Megjithatë, neni 9 nuk mbron çdo veprim të motivuar ose të frymëzuar nga një fe ose besim dhe nuk garanton gjithmonë të drejtën për t'u sjellë në sferën publike në një mënyrë që diktohet nga feja ose besimet e dikujt. Në shoqëritë demokratike, ku disa fe bashkëjetojnë brenda të njëjtës popullsi, mund të jetë e nevojshme të vendosen kufizime në lirinë për të manifestuar fenë ose besimet e dikujt, në mënyrë që të respektohen interesat e grupeve të ndryshme dhe të sigurohet që besimet e të gjithëve respektohen. Megjithatë, Gjykata konsideron gjithashtu se detyra e shtetit për neutralitet dhe paanshmëri është e papajtueshme me çdo pushtet nga ana e shtetit për të vlerësuar legjitimitetin e besimeve fetare ose mënyrat në të cilat ato besime shprehen. Roli i autoriteteve në rrethana të tilla nuk është të heqin shkakun e tensionit të mundshëm fetar duke eliminuar pluralizmin e fesë, por të sigurojnë që grupet e besimeve të ndryshme të tolerojnë njëri-tjetrin. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh në veçanti gjerësinë e kufirit të vlerësimit që i jepet shtetit të paditur në këtë çështje, Gjykata konstaton se ndalimi i vendosur nga ligji i 11 tetorit 2010 mund të konsiderohet si proporcional me qëllimin e

ndjekur, përkatësisht ruajtja e kushteve të “jetesës së bashku” si element i “mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve”. Kështu, kufizimi i kundërshtuar mund të konsiderohet si “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”. Ky përfundim është i vërtetë si për nenin 8 të Konventës ashtu edhe për nenin 9, prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 8 dhe 9 të Konventës. Në me pretendimin për shkelje të nenit 14, lidhur me nenet 8 dhe 9, duke theksuar se ndalimi ishte i justifikuar nga ligji dhe mbulonte një qëllim legjitim, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje.

* * *

Diskriminimi në vendin e punës për shkak të mbajtjes së veshjeve dhe simboleve fetare

EWEIDA DHE TË TJERËT k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

*(Kërkesat nr. 48420/10, 59842/10, 51671/10 dhe
36516/10)*

27 maj 2013

FAKTET KRYESORE Kjo kërkesë është dërguar përpara Gjykatës fillimisht nga katër kërkuës. Të katër aplikantët ishin praktikantë të krishterë të cilët u ankuan se ligji vendas kishte dështuar në mënyrë adekuate në mbrojtjen e të drejtës së

tyre për të shfaqur bindjet e tyre fetare. Kërkuesja e parë, znj. Eweida, një punonjëse e British Airways, dhe kërkuesja e dytë, znj. Chaplin, një infermiere geriatrike, u ankuan se punëdhënësit e tyre kishin vendosur kufizime në mbajtjen e kryqeve të krishterë rreth qafës në mënyrë të dukshme gjatë punës. Kërkuesja e tretë, znj. Ladele, nëpunëse e gjendjes civile të lindjeve, vdekjeve dhe martesave; dhe kërkuesi i katërt, z. McFarlane, një këshilltar për shërbime konfidenciale të terapisë seksuale dhe këshillimit të marrëdhënieve, u ankua se ata ishin pushuar nga puna për shkak të refuzimit për të kryer disa nga detyrat e tyre, të cilat sipas tyre, do t'i detyronin të falnin homoseksualitetin, një praktikë që ishte e papajtueshme me besimet e tyre fetare. Kërkuesit u ankuan për shkelje të nenit 9, dhe nenit 14 të KEDNJ.

VENDIMI I GJYKATËS Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 9, Gjykata solli në vëmendje praktikën e saj, sipas së cilës, nëse një person është i mundur të ndër marrë veprime për të siguruar respektimin e lirisë së tij të ndërgjegjes, besimit dhe fesë, atëherë nuk do të konsiderohet se ka cënim të kësaj të drejte dhe ndërhyrje në nenin 9/2. Megjithatë, në rastin e cënimit të kësaj lirie në vendin e punës, Gjykata u shpreh se ndërrimi i vendit të punës nuk do të ishte veprimi i parë që duhej ndër-

marrë nga personi që ndihej i cenuar, por rrethanat duhet të shqyrtohen nën dritën e proporcionalitetit të ndërhyrjes. Në rastin e kërkueses së parë dhe kërkuetit të 4, duke qenë se punëdhënësit ishin kompani privatë, Gjykata do të vlerësojë detyrimin pozitiv të autoriteteve shtetërore për sigurimin e respektimit të nenit 9. Në lidhje me nenin 14, Gjykata u shpreh se ndër të tjera, ai konsiston edhe në detyrimin e autoriteteve për të trajtuar në mënyrë të ndryshme, persona të cilët ndodhen në situata të ndryshme. Këto veprime janë diskriminuese në rast se janë të pajustificueshme objektivisht dhe nuk ndjekin një qëllim të ligjshëm.

Në lidhje me kërkuesen e parë, Gjykata vlerësoi se ndalimi i znj. Eweda përtëveshur kryqin në punë ishte në fakt shkelje e lirisë së saj të besimit, megjithatë, duke marrë në konsideratë se punëdhënësi i saj ishte një kompani private, Gjykata duhet të shqyrtonte detyrimin pozitiv të shtetit në dritën e nenit 9. Qëllimi i uniformës së British Airways për të komunikuar një imazh të caktuar të kompanisë dhe për të promovuar njohjen e markës dhe stafit të saj, ishte legjitim. Megjithatë, gjykatat vendase i kishin dhënë shumë peshë këtij synimi. Kryqi i kërkueses ishte jo shumë i dukshëm dhe nuk mund të prishte pamjen e saj profesionale. Nuk kishte asnjë provë që mbajtja e veshjeve fetare të autorizuara më parë, si tur-

banët dhe hixhabet nga punonjës të tjerë, të kishte ndonjë ndikim negativ në markën ose imazhin e British Airways. Për më tepër, fakti që kompania më vonë arriti të ndryshonte kodin e uniformës për të lejuar veshjen e dukshme të bizhuterive simbolike fetare, tregoi se ndalimi i mëparshëm nuk kishte qenë i një rëndësie vendimtare. Prandaj, duke qenë se nuk kishte prova për ndonjë cenim real të intereseve të të tjerëve, autoritetet vendase kishin dësh-tuar në mbrojtjen e së drejtën së kërkueses së parë për të shfaqur fenë e saj, duke shkelur detyrimin pozitiv sipas nenit 9. Asnjë shqyrtim i veçantë i ank-esës së saj sipas nenit 14 në lidhje me nenin 9 ishte e nevojshme. Në lidhje me 3 kërkuesit e tjerë, Gjyka-ta vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 9 të parë me vete dhe në lidhje me nenin 14.

* * *

HOFFMANN k. AUSTRISË

(kërkesa nr. 12875/87)

23 qershor 1993

FAKTET KRYESORE Kërkuesja dhe bashkëshor-ti i tij, janë një çift katolik romak, të cilët kanë dy fëmijë të pagëzuar që në lindje. Më vonë, kërkues-ja u konvertua në Dëshmitare e Jehovait, la bash-këshortin duke marrë dhe fëmijët me vete dhe u nda

zyrtarisht në vitin 1986. Gjatë procedurave të divorcit, palët kërkonin kujdestarinë e fëmijëve, e cila nga ana e bashkëshortit u kundërshtua me pretendimin se duke qenë Dëshmitare e Jehovahit, nuk do të ishte në gjendje ti rriste fëmijët si= duhej, duke qenë se kjo fe parashton një sërë kufizimesh për praktikantët e saj në lidhje me takimin me familjarët, ndjekjen e arsimit, etj. Në janar 1986, Gjykata i dha kërkuases kujdestarinë e fëmijëve me pretendimin se ajo do të ishte më e mundur të kujdesej për fëmijët, duke qenë se nuk ishte në marrëdhënie pune, si dhe për faktin se ndarja e fëmijëve nga e ëma do të ishte një shok emocional për fëmijët, sipas psikologes. Ish-bashkëshorti apeloj kërkesën me pretendimin se ndjekja e asaj feje do ti izolonte fëmijët nga aspekti social dhe kjo gje do të sillte efekte të tjera negative, megjithatë gjykata rajonale e hodhi poshtë këtë kërkesë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë u shpreh se nuk ishte vlerësuar interesi më i lartë i fëmijës, jo vetëm lidhur me arsimimin dhe edukimin, por edhe me çështjen e shëndetit. Kërkuësja kishte refuzuar të jepte pëlqimin për transfuzionin e gjakut dhe vonesa në këto procedura do të rrezikonte jetën e fëmijëve gjatë një operimi të mundshëm. Duke vlerësuar edhe faktin se nuk kishte fakte që vërtetonin se ndryshimi i kujdestarisë të fëmijëve do të sillte shok të papërbalueshëm emocional për fëmijët, Gjykata u shpreh për dhënien e kujdestarisë

ish-bashkëshortit. Kërkuesja pretendoi për shkelje të nenit 8 dhe në 9, marrë më vete dhe së bashku me nenin 14 të KENDNJ.

VENDIMI I GJYKATËS Gjykata e mori në shqyrtim kërkesën vetëm në bazë të nenit 8, marrë së bashku me nenin 14. Vendimi i Gjykatës së Lartë që detyron kërkuesen t'ia dorëzojë fëmijët babait të tyre, përbën një ndërhyrje në të drejtën e saj për respektimin e jetës së saj familjare. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të bëra, është e përshtatshme të shqyrtohet çështja sipas nenit 8 të marrë në lidhje me nenin 14. Gjykata Evropiane nuk e mohon që, në varësi të rrethanave të çështjes, faktorët në të cilët mbështetet Gjykata e Lartë (refuzimi i festave publike, kundërshtimi i transfuzionit të gjakut, pozicioni si pakicë shoqërore) mund të kenë në vetvete aftësinë të përmbysin situatën në favor të njërit prind dhe jo të tjetrit. Megjithatë, Gjykata e Lartë prezantoi gjithashtu një element të ri, përkatësisht Aktin Federal për Edukimin Fetar të Fëmijëve, të cilin e konsideroi vendimtar - GJEDNJ pranon se kishte një ndryshim në trajtim në bazë të fesë. Qëllimi i ndjekur ishte legjitim, pikërisht mbrojtja e shëndetit dhe e të drejtave të fëmijëve. Për aq sa Gjykata e Lartë nuk u mbështet vetëm në Aktin Federal për Edukimin Fetar të Fëmijëve, ajo i peshoi faktet ndryshe nga gjykatat e mëparshme, arsye-

timi i të cilave u mbështet për më tepër nga opinioni i ekspertit psikolog, pavarësisht nga argumentet e mundshme për të kundërtën. Një dallim i bazuar në thelb vetëm në një ndryshim në fe nuk është i pranueshëm, prandaj nuk ekzistonte asnjë marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur. Si përfundim, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 8 marrë së bashku me nenin 14 dhe nuk ishte e nevojshme të merrej në shqyrtim neni 8 më vete. Kërkesa në lidhje me nenin 9 kishte të njëjtën bazë si shqyrtimi në lidhje me nenin 8, kështu që nuk u mor parasysh nga Gjykata.

ASPEKTI KOMBËTAR I LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË

III. ASPEKTI KOMBËTAR I LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË

3.1 Këndvështrimi historik i lirisë së mendimit, besimit dhe fesë në shtetin shqiptar

Si në shumë shtete të tjera edhe në Shqipëri marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë kanë karakterizuar realitetin tonë shoqëror. Me kalimin e viteve studimet në këtë fushë kanë ardhur në rritje, ndërsa marrëdhëniet reciproke shtet-institucion fetar mund të klasifikohen si respektuese dhe paqësore, sidomos kur kryefjala është fati i kombit shqiptar përkundrejt kërcënimit të huaj apo përpjekjeve të nxitura për të trazuar ekuilibrin e arritur në dekadat e fundit.

Përgjatë periudhës mbi një shekullore prej shpalljes së shtetit të mëvetëm shqiptar ka patur zhvillime legjislative edhe përsa i takon rregullimit të marrëdhënieve midis shtetit dhe besimit fetar apo edhe institucioneve fetare.

Kështu, Ligji mbi fenë gjatë periudhës së drejtimit të shtetit nga Mbreti Zogu I, i vitit 1929, siguronte të drejtën e besimit, por vendoste në zgjedhjen e krerëve fetarë dhe iu ndalonte klerikëve në detyrë, të drejtën e votimit në zgjedhjet politike.

Komunitetet fetare ishin të lidhura, me Ministrinë e Drejtësisë, dhe të gjitha marrëdhëniet e tyre me Qeverinë kryheshin me anën e saj, e cila kishte të drejtë edhe t'i inspektonte ato. Po sipas ligjit, Mbreti mund të ndryshonte drejtuesit e komuniteteve fetare sa herë që ai konstatonte se ata ishin duke shkelur ligjin. Komunitetet fetare nuk duhej të merrnin asnjë ndihmë e subvencion nga jashtë. Shpenzimet e tyre për qëllime humanitare, duhej të miratoheshin nga qeveria.¹

¹ Fletorja Zyrtare, 1 shkurt 1939, nr. 8, cituar në Studim mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri, A.L.T.R.I. Canada Fund for local initiatives, Tiranë, 2016, fq.13

Më 1 shtator 1928, në mënyrë unanime, Kuvendi Kushtetues, miratoi ndryshimet në Kushtetutë, sipas së cilave Shqipëria shpallej Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe e trashëgueshme. Gjithashtu, kjo Kushtetutë sanksiononte se: “Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë dhe të gjithë besimet respektohen dhe garantohet ushtrimi i lirë i tyre. Feja në asnjë mënyrë nuk mund të shërbejë si ndalesë ose pengesë juridike e çdo lloji. Feja dhe besimet nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë për realizimin e synimeve politike”.²

Mbas Luftës së Dytë Botërore, me ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste vendi kaloi në një sistem politik qeverisës monist dhe në raport me besimin fetar shteti ishte ateist. Gradualisht, duke ndaluar lirinë e besimit në vitin 1967, shteti filloi përndjekjen e predikuesve dhe mbylljen e objekteve të kultit. Me Dekretin Nr. 4263, datë 11. 04. 1967 u vendos që pasuritë e bashkësive fetare bëhen pronë e shtetit. Ndërsa Dekreti 4337, datë 13 11 1967 vendosi shfuqizimin e Dekreti 743 i vitit 1949 për bashkësitë fetare. Kështu që komunitetet fetare u lanë jashtë njohjes ligjore dhe për këtë arsye ata nuk mund të zhvillonin asnjë

² “Dekret–Ligj mbi formimin e Komuniteteve Fetare”, botuar në gazetën zyrtare, më 1 shkurt 1930, cituar në Studim mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri, A.L.T.R.I. Canada Fund for local initiatives, Tiranë, 2016, fq.13

veprimtari dhe u shkatërruan pa dallim objektet fetare myslimane, katolike ose ortodokse, duke u justifikuar si lëvizje rinore ateiste. Institucionet fetare u kthyen në objektet për zhvillimin e aktiviteteve publike dhe të tjera u shembën plotësisht. Rreth 217 klerikë u burgosën dhe përfunduan jetën në burg ose u pushkatuan, mbështetur në Kodin Penal të 1977.³

Në vitet 1990 Shqipëria nuk kishte një organizim institucional që rregullon marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare të rilindura. Pas dekadash të shtypjes komuniste, elita politike dhe komunitetet fetare ndjenë nevojën e zgjerimit dhe vendosjes së organeve që sigurojnë lirinë fetare. Opozita e parë politike premtoi të vendosë “*lirinë e ... besimit dhe ushtrimit të tij*”. Parlamenti i parë pluralist i formuar pas zgjedhjeve të vitit 1991 siguroi “*lirinë fetare dhe krijimin e kushteve për ushtrimin e saj*”. Pavarësisht gjithë përpjekjeve mund të thuhet se rregullimi formal i aktiviteteve fetare mori pothuajse një dekadë për t’u përmbushur. Në mungesë të një baze ligjore marrëdhëniet midis shtetit dhe komuniteteve fetare ishin vendosur në mënyrë të pasistemuar dhe mbi bazën e vullnetit të mirë mes palëve.

³ Evalda Jera, Freedom of Religion and Social Conflict. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 3(3), 2014, 553 ISSN 2039-2117, gjendet në <https://www.richtmann.org/journal/index.php/ajis/article/view/3835>

Në 1992 insitucioni i vetëm për të marrëdhënieve fetare ishte Sekretariati i Shtetit. Në vitin 1998, ligji kushtetues parashikoi në mënyrë më të hollësishme ndarjen e shtetit nga feja, vendosjen e bashkëpunimit midis shtetit dhe organizatave fetare, si dhe të drejtat e organizatave fetare.

Kushtetuta i lejon organizatat fetare të marrin statusin e “personit juridik” dhe për këtë duhet të regjistrohen në Gjykatën e Tiranës, e cila ka kompetencën për të gjykuar përshtatshmërinë e tyre me legjislacionin e shtetit.

Ndërkohë, shteti nga ana e tij, është angazhuar jo vetëm për shpalljen e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, por edhe për pasurimin e së drejtës së ushtrimit të fesë duke përmirësuar legjislacionin në këtë fushë dhe duke u bazuar në konventa ndërkombëtare e rajonale mbi të drejtat e njeriut, duke u anëtarësuar në këto organizata dhe duke njohur mekanizmat për garantimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi, duke përfshirë edhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit.

Aktualisht, Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion shtetëror qendror që mbulon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare. Komiteti Shtetëror për Kultet ka kompetenca për plotësimin

e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e Shtetit me fenë, ruajtjen dhe zhvillimin e harmonisë ndërfetare në vend.

Në vendin tonë ekzistojnë këto bashkësi fetare:

- ❖ Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
- ❖ Kisha Ortodokse Autoqefale
- ❖ Kisha Katolike në Shqipëri
- ❖ Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe
- ❖ Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë,

që i përkasin traditës shqiptare të fesë dhe që kanë lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave dhe disa besime të tjera, të reja që janë përkrahur nga shoqëria shqiptare me ardhjen e pluralizmit politik në këto tri dekadat e fundit. Baza kryesore kushtetuese për ushtrimin e lirisë së besimit janë nenet 10, 18 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilat do të trajtohen në një seksion më vete të këtij manuali.

Fetë më të zakonshme të praktikuar në Shqipëri janë islami dhe krishtërimi, ndërkohë që një pjesë e shqiptarëve nuk ndjekin apo praktikojnë ndonjë besim fetar. Shqipëria sipas kushtetutës nuk ka fe zyrtare dhe shteti është asnjëanës në çështjet e ndërgjegjes.

Në vitin 2011, në Shqipëri u zhvillua censusi i popullsisë dhe sipas rezultateve të tij grupi më i madh fetar ishin myslimanët sunitë 56.7%, që pasoheshin nga katolikët (10.03%), ortodoksët (6.75%) dhe bektashinjtë (2.09%).⁴

Pjesa tjetër prej 21.78% përbëhej nga të padeklaruar, besimtarë që nuk identifikoheshin me ndonjë fe dhe ateistë.

3.2 Pasqyrimi i lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në paketën kushtetuese shqiptare në vitet '90 dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë prej 1998

Të drejtat dhe liritë individuale dhe kolektive që gëzojmë në ditët tona, të njohura dhe garantuara nga shteti dhe që shpesh i konsiderojmë të mirëqena, janë shpallur, njohur, gëzuar dhe mbrojtur në më pak se një shekull në nivel global, ndërsa në shtetin shqiptar kanë si pikënisje dekadën e fundit të shekullit XX. Në fillim të viteve '90 Shqipëria përjetoi ndryshime historike në politikën, ekonominë dhe

⁴ Studim mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri, A.L.T.R.I. Canada Fund for local initiatives, Tiranë, 2016, fq.9

organizimin shoqëror duke lënë pas qeverisjen me metoda totalitariste dhe duke synuar qeverisjen demokratike.

Pikënisja e njohjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut në vendit tonë ishte Ligji nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese””, pararendës i ligjit kushtetues aktual.

Me anë të këtij ligji për herë të parë në Shqipëri u njohën një sërë lirish dhe të drejtash të njeriut, duke përfshirë të drejtën e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Kështu në këtë ligj parashikohet se ***liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë janë të padhunueshme, si dhe kushdo është i lirë të ndryshojë fenë apo bindjet, si dhe t'i manifestojë ato individualisht ose kolektivisht në publik ose në jetën private nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve***⁵.

Megjithatë kjo liri nuk parashikohej të ishte e pakufizuar pasi po në të njëjtin nen parashikohej se

⁵ Neni 18 Liria e ndërgjegjes dhe e fesë, Ligji nr.7692, datë 31.3.1993 Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”

liria për të manifestuar fenë apo bindjet nuk mund të jetë objekt i kufizimeve të tjera, **përveçse atyre të parashikuara me ligj, të cilat përbëjnë masa të nevojshme të një shoqërie demokratike në interes të sigurisë publike, mbrojtjes së rendit publik, shëndetit, moralit, të drejtave e lirive të të tjerëve.**⁶

Pra, kundërpesha për të mos e lënë të lirë në mënyrë absolute lirinë e mendimit, ndërgjegjës dhe fesë ishte siguria publike, mbrojtja e rendit publik që kanë të bëjnë me kolektiven, si dhe mbrojtja e shëndetit moralit dhe lirive dhe të drejtave që u përkasin të tjerëve.

Ky ligj qëndroi në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Kushtetutës aktuale të miratuar në vitin 1998, e cila ka një pjesë të posaçme dedikuar lirive dhe të drejtave të njeriut.⁷

*Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare.⁸
Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.
Shteti njuh barazinë e bashkësive fetare.*

⁶ Po aty

⁷ Pjesa II, Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998

⁸ Neni 10, Pjesa I, Parimet Themelore, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve.

Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend.

Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Ky është një parashikim i rëndësishëm që vendos vijën ndarëse midis drejtimit politik të shtetit dhe aspektit fetar, ndërsa vendos edhe pikat e bashkëpunimit midis shtetit nga njëra anë dhe gjithë bashkësive fetare nga ana tjetër duke i njohur të njëjtën rëndësi dhe peshë gjithsecilit prej tyre, madje duke iu njohur personalitet juridik që formalizohet me anë të gjykatës. E drejta e pronës është një element mjaft me rëndësi pasi komuniteteve fetare iu mundësohet kthimi i pronave të sekuestruara gjatë regjimit politik të mëparshëm. Gjithashtu, komunitetet fetare mund t'i administrojnë lirisht dhe pa ndërhyrje pasuritë e tyre.

Ndarja e fesë dhe shtetit mund të themi se është themeli i sekularizmit, pasi kjo siguron që grupet fetare të mos ndërhyjnë në punët e shtetit dhe shteti të mos ndërhyjë në punët fetare. Sekularizmi mbron si besimtarët ashtu edhe jobesimtarët, ata duan që liritë e mendimit dhe ndërgjegjes të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë si për besimtarët dhe jo-besimtarët, dhe nuk dëshirojnë të kufizojnë liritë fetare. Parimet e sekularizmit të cilat mbrojnë dhe mbështesin shumë prej lirive që ne gëzojmë janë:

- ***Ndarja e institucioneve fetare nga institucionet shtetërore dhe një sferë publike ku feja mund të marrë pjesë, por jo të dominojë.***
- ***Liria për të praktikuar besimin pa dëmtuar të tjerët, ose për ta ndryshuar atë ose jo, sipas ndërgjegjes së vetë.***

Në Shqipëri përveçse njihet dhe garantohet liria për të patur dhe ushtruar ritet e një besimi fetar të caktuar njihet dhe garantohet liria e ndërgjegjes dhe e fesë edhe për të ndryshuar besimin fetar apo edhe për të mos besuar në asnjë fe.

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.⁹

⁹ Neni 24, Pjesa II, Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Kreu II, Liritë dhe të Drejtat Vetjake, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.¹⁰

Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.¹¹

Në këtë nen shohim lidhjen e besimit fetar me të drejtën për arsim, pra marrjen e njohurive për besimin fetar të zgjedhur. Kjo lidhje trajtohet më gjerësisht në një seksion të posaçëm të këtij manuali. Gjithashtu, e drejta e ndërgjegjes dhe e fesë shihet e lidhur me të drejtën për një jetë private, pa patur detyrimin për të ndarë me të tjerë apo bërë publike mendimet, bindjen apo besimin fetar.

Elementi besim fetar ndërthuret edhe me parashikime të tjera të Kushtetutës, në pjesën e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kështu, pavarësisht individualizmit të secilit person, Kushtetuta deklaron se të gjithë konsiderohemi të barabartë përpara ligjit.¹²

¹⁰ Po aty, pika 2

¹¹ Po aty, pika 3

¹² Neni 18, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ky parashikim çohet edhe më tej me dhënien e elementeve të individualizmit, të cilat nuk duhen të përdoren për të përligjur dallimin dhe trajtimin ndryshe. Bindja fetare është një nga këto elemente.¹³

Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Për më tej personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.¹⁴

3.2.1 Toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa fetare

Toleranca fetare në Shqipëri është një çështje e trajtuar si një karakteristikë kombëtare dhe pjesë e krenarisë kombëtare. Jo rrallë herë kjo vlerë është përdorur edhe nga liderët politikë, si një “çelës” për

¹³ Po aty, pika 2

¹⁴ Neni 20, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

të promovuar Shqipërinë e paqme dhe harmonike në arenën ndërkombëtare.¹⁵

Shqipëria karakterizohet nga tolerancë fetare, si një pikënisje për komunikimin paqësor fetar, i cili ka shërbyer për të forcuar kulturën e tolerancës fetare. Historikisht, në vendin tonë gjuha shqipe ka karakterizuar kombin dhe unitetin midis shqiptarëve dhe jo përkatësia fetare dhe këto parakushte kanë ndihmuar ruajtjen e tolerancës fetare.

Në një shoqëri demokratike toleranca duhet të motivohet jo vetëm nga solidariteti etnik, por edhe nga respektimi i të drejtave të njeriut dhe shteti ligjor dhe “toleranca fetare” shihet se është më e përshtatshme sesa “harmonia fetare”.¹⁶

Në Shqipëri si shembujt të tolerancës fetare përmenden kryesisht martesat e përziera fetare, kremtimet e festave fetare të besimeve të tjera dhe bashkëjetesa paqësore e shqiptarëve me prejardhje të ndryshme fetare. Shqiptarët i japin rëndësi më të madhe ndarjes ligjore dhe praktike mes shtetit dhe

¹⁵ Dalina Jashari, Toleranca fetare në Shqipëri si një traditë dhe kulturë shoqërore, Moderator, 25 shtator 2018, fq 1, gjendet në <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albanian.pdf>

¹⁶ Po aty

fesë, laicitetit, si një tipar të shoqërisë dhe faktor po aq i rëndësishëm në nxitjen e tolerancës fetare.¹⁷

Toleranca fetare është një vlerë e mbështetur gjerësisht nga qytetarët shqiptarë si një vlerë qytetare, morale dhe traditë kombëtare. Nga një studim i kryer në 2018, më shumë se gjysma e shqiptarëve kanë pak ose aspak njohuri për fetë e ndryshme në Shqipëri, ndërsa rreth 36 për qind e pjesëmarrësve në studim janë deklaruar me njohuri mesatare ose të gjera mbi fetë.¹⁸ Shqiptarët kanë prirjen të mos e mbështesin epërsinë e një besimi të veçantë fetar, ndërsa përqendrohen më shumë në elementet e përbashkëta të feve dhe vlera të shenjta që i shërbejnë jetesës paqësore në një shoqëri të shumëllojshme.

3.2.2 Edukimi fetar në Shqipëri

Shumëllojshmëria kulturore dhe fetare janë të pranishme në çdo vend. Asnjë shtet nuk është homogjen nga pikëpamja kulturore. Disa njerëz besojnë te Zoti; disa të tjerë janë ateistë, të tjerë janë agnostikë. Këto janë tri tipet e mëdha të zgjedhjeve

¹⁷ Dalina Jashari, Toleranca fetare në Shqipëri si një traditë dhe kulturë shoqërore, Moderator, 25 shtator 2018, fq 6

¹⁸ Toleranca Fetare në Shqipëri, IDM & UNDP, 2018, fq.5 gjendet në https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/religious_tolerance

shpirtërore.¹⁹ Edukimi në një shoqëri demokratike dhe pluraliste synon lulëzimin personal dhe social të çdo njeriu. Në këtë kontekst, vlerat fetare formojnë një fushë mjaft të ndjeshme, sepse ato kanë të bëjnë me besimet dhe kuptimin për botën.

Nga ana tjetër feja dhe besimi nuk janë çështje tërësisht private dhe janë pjesë e dialogut brenda sferës publike. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të informohen për dukuritë dhe faktorët që ndikojnë në jetën e tyre, ndërsa shteti ka detyrimin ligjor t'ua bëjë të mundur këtë informacion përmes arsimit, në mënyrë cilësore, të strukturuar e në përputhje me parimet e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës. Edukimi ndërkulturor duhet të synojë tri objektiva të mëdha; tolerancën, reciprocitetin dhe frymën e qytetarisë.²⁰

Procesi i të mësuarit të faktit fetar dhe jo fetar, të këndvështrimeve fetare dhe jo fetare kanë bazë kushtetuese, tek të drejtat e njeriut, barazia, liria nga diskriminimi dhe liria e ndërgjegjes, besimit fetar, e mendimit, e besimit. Në kuadrin kushtetues, shkollat publike kanë detyrimin për të nxitur dhe për

¹⁹ Gjergj Sinani, Feja dhe Edukimi, Fondacioni "Friedrich Ebert", Albdesing, Tiranë 2017, fq.26, gjendet në <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/13999.pdf>

²⁰ Po aty, fq.14

të zhvilluar vlerat themelore të shoqërisë demokratike, përmes kurrikulës dhe veprimtarive ekstrakurrikulare.

Një karakteristikë të drejtës për arsim garantuar nga Kushtetuta është karakteri pluralist i arsimit. Kjo karakteristikë e sistemit arsimor vendos lejon prindërit të zgjedhin institucionin ku do të edukojnë fëmijët e tyre, i cili mund të jetë publik ose privat, laik ose fetar. Karakteri plural i kësaj të drejte përfshin mundësinë e prindërve për të arsimuar fëmijët sipas bindjeve të tyre filozofike ose fetare, duke respektuar këtu dhe laicitetin e shkollës publike.²¹

3.2.3 Kundërshtimi i ndërgjegjes

E drejta për kundërshtim të ndërgjegjes rrjedh nga liria e bindjes personale, ndërgjegjja dhe mendimi, dhe liria fetare. Ajo lejon që një person të lirohet nga disa detyra ligjore, sepse ato bien ndesh me bindjet e tyre fetare, morale, filozofike ose humanitare. Kundërshtimi i ndërgjegjes prek kryesisht sferën e mbrojtjes, ku, në rrethana të caktuara, një person mund të kërkojë (dhe shteti mund t'u lejojë) përjashtim nga detyra civile e shërbimit ushtarak, pra

²¹ Elvin Gjevori & Ina Xhepa, Manual E drejta për Arsim, KAS & Fondacioni Qendra Europiane, Tiranë, 2020, fq. 20

shteti mund të sigurojë rrethana të përshtatshme që personat e tillë të ushtrojnë të drejtën e tyre, por edhe detyrimin e tyre për mbrojtjen e shtetit në një mënyrë që nuk bie ndesh me bindjet e tyre të brendshme dhe personale.

Kundërshtimi i ndërgjegjes është shfaqje e jashtme e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ku kjo e drejtë përfshinë edhe lirinë e ndërrimit të fesë dhe besimit. Prandaj, nuk ka dyshim se liria përfshin krijimin, ndryshimin dhe braktisjen e perceptimeve të caktuara personale, bindjeve morale ose fetare. Ajo që në një moment është e pranueshme për ndërgjegjen dhe bindjen njerëzore, nuk do të thotë se është e përhershme dhe se mund të pësojë ndryshime me kalimin e kohës.

Kushtetuta shqiptare parashikon se “*shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligj.*”

Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në forcat e armatosura, është i detyruar të kryejë një shërbim alternativ, siç parashikohet në ligj.”²²

²² Pjesa XV - Forcat e armatosura - Neni 166, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

3.3 Institucionet fetare – Bashkësitë fetare në Shqipëri

3.3.1 Të drejtat që gëzojnë bashkësitë fetare

Në Shqipëri legjislati i lejon komuniteteve fetare të drejtojnë institucione arsimore, si dhe të ndërtojnë dhe administrojnë varreza fetare në tokat që ato komunitete zotërojnë.

Shkollat publike janë laike dhe ligji ndalon mësimet fetare në to. Shkollat private mund të ofrojnë mësim fetar. Sipas shifrave zyrtare të 2016-ës, grupet, organizatat dhe fondacionet fetare kanë 125 shoqata dhe fondacione anëtare që menaxhojnë 116 institucione arsimore, përfshirë universitete, shkolla fillore, të mesme, dhe parashkollore, kopshte, shkolla profesionale dhe jetimore. Sipas legjislatit, këto shkolla duhet të licensohen nga Ministria që mbulon fushën e arsimit dhe programi jofetar duhet të jetë në përputhje me standardet kombëtare të arsimit.

Grupet katolike, myslimane dhe ortodokse kanë në veprim një numër kopshtesh, shkollash dhe universitetesh të licensuara nga shteti. Shumica prej tyre nuk kanë orë fetare të detyruara, por i ofrojnë ato me zgjedhje. Komuniteti mysliman ka gjashtë mëdrese që japin mësim fetar përpos programit të përcaktuar nga shteti.

Në vitin 2016, Kryeministri Edi Rama shpalli një program të ri për arsimin fetar në shkolla, ndërtuar për të ndihmuar parandalimin e radikalizimit dhe për të promovuar tolerancën fetare. Si Kryeministri ashtu edhe Ministri i Arsimit vazhduan të deklaronin se programi nuk do të ndikonte natyrën laike të sistemit arsimor të vendit. Grupet fetare nuk e kundërshtuan këtë deklaram.

Parlamenti ka miratuar një ligj për pakicat kombëtare, i cili ofronte mbrojtje shtesë për të drejtat e pakicave, përfshi lirinë e fesë.

Përfaqësuesi i OKB-së për lirinë e fesë, Ahmed Shaheed, ka deklaruar se “Shqipëria është një model për harmoninë ndërfaqetare.”²³

3.3.2 Marrëveshjet midis shtetit shqiptar dhe bashkësive fetare

Kushtetuta parashikon se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregullohen me marrëveshje të veçanta, të cilat marrin vlerën e ligjit duke qenë se ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Marrëveshja e parë e lidhur në zbatim të nenit 10

²³ Raport Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë për 2017 Departamenti i Shtetit i SHBA, Byroja e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punës <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2017-Raporti-Liria-e-Fese-Shqiperi-FINAL.pdf>

të Kushtetutës ishte ajo “Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.²⁴

Kjo ishte marrëveshja e parë mes shtetit shqiptar dhe një komuniteti fetar që i hapi rrugën edhe marrëveshjeve të tjera analoge mes komuniteteve dhe shtetit shqiptar. Duhet theksuar se kjo marrëveshje bazohet dhe në nenin 121 të Kushtetutës duke qenë se është lidhur ndërmjet shtetit shqiptar dhe një shteti, subjekt i së drejtës ndërkombëtare siç është Selia e Shenjtë, pra trajtohet nga e drejta ndërkombëtare.

Sa më sipër, duke qenë se marrëveshja me Selinë e Shenjtë ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ka efekte financiare për shtetin shqiptar, ajo i është nënshtruar ratifikimit nga Kuvendi. Në bazë të kësaj marrëveshjeje shteti shqiptar njeh personalitetin juridik të Kishës Katolike. Ai merr përsipër të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe të asistojë në reregjistrimin e tyre në emër të Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore. Prej kësaj marrëveshjeje lind detyrimi ligjor i shtetit shqiptar që t'i rikthejë pa asnjë kushtëzim të gjitha pronat e kishës katolike të shtetëzuara gjatë periudhës së sistemit komu-

²⁴ Ratifikuar me Ligjin nr. 8902, datë, 23.5.2002

nist dhe t'i garantojë komunitetit katolik të gjitha të drejtat pasurore në lidhje me këto prona. Për më tej, kjo marrëveshje parashikon se Kisha Katolike ka të drejtën të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.²⁵

Në vijim, shteti shqiptar lidhi në vitin 2009 marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella me tre komunitete të tjera: Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSH),²⁶ Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (KOASH)²⁷ dhe Kryegjyshatën Botërore Bektashiane (KBB),²⁸ e më pas në vitin 2011 u lidh marrëveshja me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë.²⁹

²⁵ Neni 4, Ligj nr.8902, datë 23.5.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”

²⁶ Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, ratifikuar me Ligjin nr.10 056, datë 22.1.2009.

²⁷ Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, ratifikuar me Ligjin nr.10 057, datë 22.1.2009

²⁸ Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin nr.10 058, datë 22.01.2009.

²⁹ Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

Sipas këtyre marrëveshjeve që në përmbajtje janë thuar se të njëjta, por të miratuara në kohë të ndryshme, shteti deklaroi se respekton bashkësitë fetare të Shqipërisë dhe njih si përfaqësues të saj vetëm personat e autorizuar nga Komuniteti përkatës dhe garanton mbrojtjen e tyre nga çdo person ose grup që pretendon emrin, objektet e kultit, pronat, simbolet dhe vulën e komunitetit përkatës. Nga ana tjetër, çdo komunitet fetar i njohur dhe i regjistruar në Republikën e Shqipërisë respekton bashkësitë e tjera fetare të njohura në Shqipëri, besimtarët e tyre dhe ritet që ata praktikojnë. Çdo bashkësi fetare ka të drejtë të organizohet dhe të realizojë misionin e vet në mënyrë të pavarur nga shteti, duke respektuar parimin e laicitetit të shtetit, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Në marrëdhëniet e ndërsjella me komunitetet fetare shteti përfaqësohet nga Komiteti Shtetëror për Kultet.

Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe mbarimi i komuniteteve fetare si person juridik realizohet në përputhje me rregullat e traditat përkatëse dhe me legjislacionin në fuqi. Shteti iu njih komuniteteve fetare të drejtën për të krijuar institucione e struktura me karakter fetar ose jofetar, të cilat e fitojnë ose e kanë statusin e personit juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Institucionet e strukturat e krijuara nga komuniteti fetar mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e veta, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë, ndërmjet të tjerave, edhe pajisjen me licenca dhe lejet përkatëse. Në fushën e arsimit, shteti dhe bashkësitë fetare angazhohen që arsimimi i fëmijëve të bazohet mbi të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, të drejtohet në për gatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe vëllazërisë midis njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare, ose personave me origjinë tjetër, duke iu kundërvënë racizmit e fanatizmit.

Gjykata përgjegjëse për njohjen e personalitetit juridik të bashkësive fetare është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse për regjistrim nga një komunitet fetar bën njohjen e personit juridik dhe regjistrimin e tij, nëpërmjet nxjerrjes së vendimit përkatës.

Për ushtrimin e lirisë së besimit nga individët Ndërtesat dhe objektet që shërbejnë për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të shenjta dhe ndërhyrja e autoriteteve në to është e ndaluar, me

përrjashtim të rasteve të flagrancës, kur një gjë e tillë kërkohet në zbatim të një urdhri të prokurorisë, të një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv, ose në rast të kanosjes së një rreziku të afërm. Institucionet përkatëse shtetërore dhe në veçanti Komiteti Shtetëror i Kulteve, bashkëpunojnë me bashkësitë fetare për të përcaktuar vendin për ndërtimin e objekteve fetare, në përputhje me nevojat fetare të personave, si dhe mbi bazën e planeve rregulluese urbanistike.

Në marrëveshjet me komunitetet fetare shteti shqiptar mund t'u japë mbështetje financiare ose materiale. Për më tej shteti angazhohet dhe parashikon me ligj të posaçëm ditët e festave fetare që janë ditë pushimi.

3.4 Institucionet shtetërore me kompetenca në fushën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë

3.4.1 Këshilli i Ministrave

marrëdhëniet dypalëshe midis shteti dhe bashkësitë fetare rregullohen në bazë të marrëdhënieve të lidhura midis përfaqësuesve të tyre dhe Këshilli i Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen nga Parlamenti. Pra, bashkësitë fetare janë të pavarura nga shteti. Nga pikëpamja e bashkësive të brendshme

fetare, ato konsiderohen si një element i shoqërisë organ, i pajisur me personalitetin e vet juridik dhe autonominë organizative dhe menaxheriale, sipas rregullave të përgjithshme ligjore. Si burime ligjore, që rregullojnë marrëdhëniet e bashkësive fetare, janë nënshkruar dhe ratifikuar katër marrëveshjet. Ajo ratifikoi marrëveshjen midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë Vatikanit në 2005.³⁰

Qeveria nuk kërkon regjistrimin ose licencimin e grupeve fetare, por një grup fetar duhet të regjistrohet në gjykatën e rrethit si një shoqatë jofitimprurëse për t'u kualifikuar për përfitime të caktuara, duke përfshirë hapjen e një llogarie bankare, zotërimin e pronës dhe përjashtimin nga taksat e caktuara. Procesi i regjistrimit kërkon dorëzimin e informacion mbi formën dhe fushëveprimin e organizatës, aktivitetet e saj, identitetet e themeluesve dhe përfaqësuesve ligjorë të saj, natyrën e ndërveprimeve të saj me aktorët e tjerë (p.sh. ministritë qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile) dhe adresën e organizatës, si dhe një tarifë regjistrimi të ulët.

³⁰ Evalda Jera, Freedom of Religion and Social Conflict. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 3(3), 2014, 553 ISSN 2039-2117, gjendet në <https://www.richtmann.org/journal/index.php/ajis/article/view/3835>

Parashikimet ligjore të miratuara në 2009 lejojnë qeverinë të sigurojë mbështetje financiare për katër bashkësitë fetare, me të cilat kishte marrëveshje në atë kohë. Kjo dispozitë e ligjit nuk përfshin VUSH, marrëveshja e të cilit me qeverinë daton nga viti 2011. Nuk ka asnjë dispozitë të ligjit për t'i siguruar VUSH mbështetje financiare nga qeveria.

Këto marrëveshje parashikojnë të drejtën e pronësisë të komuniteteve fetare ndërkohë që tre marrëveshjet e para vendosin shtetin para detyrimit për kthimin e kompensimin e pronave të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në të gjitha marrëveshjet përcaktohet se në rastet kur objektet e kultit të komuniteteve fetare nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (sot Agjencia e Trajtimit të Pronës), si institucion përgjegjës për verifikimin, kthimin dhe kompensimin e pronave, merr përsipër detyrimin për ta vërtetuar pronësinë mbi objektin e kultit nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit. Në këto marrëveshje parashikohet, gjithashtu, që objektet e kultit të cilat gëzojnë statusin e Monumentit të Kulturës, t'i kthehen në pronësi komuniteteve fetare dhe të mbrohen e trajtohen nga ligji për trashëgiminë kulturore.

Si Kryetar i Përgjithshëm i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në 2020, Kryeministri Edi Rama priti një konferencë mbi luftimin e antisemitizmit më 4-5 shkurt në Tiranë. Më 28 tetor, parlamenti mbajti një forum online mbi shkatërrimin e antisemitizmit. Para forumit, Parlamenti miratoi njëzëri përkufizimin e Aleancës Ndërkombëtare të Kujtimit të Holokaustit për antisemitizmin.³¹

3.4.2 Komiteti Shtetëror i Kulteve

Komiteti Shtetëror i Kulteve është krijuar në vitin 1999. Fillimisht ky institucion ka qenë institucion varësie i Këshillit të Ministrave, por me ndryshimet që i janë bërë akteve nënligjore që rregullojnë organizmin dhe funksionimin e tij varësia institucionale është ndaj Kryeministrit dhe me ndryshime të mëtejshme në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, apo pavarësisht emërimit të ministrisë, asaj ministrie që në portofolin e saj ka patur të përfshirë kulturën. Ndryshimi më i fundit është ai i vitit 2014 që e riktheu varësinë institucionale të Komitetit të Kulteve tek Kryeministri.

³¹ International Religious Freedom Report for 2020 United States Department of State, Chapter on Albania <https://www.state.gov/reports/2020-report-on-international-religious-freedom/albania/fq.8>

Komiteti Shtetëror për Kultet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e tij. Ky Komitet ka përgjegjësitë të bashkërendojë marrëdhëniet me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare, si dhe të negociojë për përgatitjen e marrëveshjeve ndërmjet përfaqësuesve të bashkësive fetare dhe Këshillit të Ministrave.

Një tjetër kompetencë e rëndësishme e tij është puna për garantimin e lirisë së besimit e për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndër-fetare në Shqipëri, si dhe bashkëpunimi me bashkësitë fetare për përgatitjen e projektligjeve dhe të akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me kultet fetare.

Në raport me institucione të tjera qendrore Komiteti i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mendimin e tij lidhur me planin mësimor, programet lëndore dhe teksetet e pjesës jolaike, për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në bashkëpunim me atë institucion, në varësi të ndarjes administrative territoriale, të nevojave e interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike e fetare, përcakton dhe numrin e institucioneve arsimore jopublike dhe institucioneve plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare.

Në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe me komunitetet fetare interesohet për ruajtjen e vlerave të objekteve të kultit.

Në lidhje me Ministrinë e Financave, Komiteti mendimin e tij lidhur me hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave me karakter fetar për komunitetet fetare dhe për përjashtimin e tyre nga taksa doganore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.4.3 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion publik i pavaruar, i cili është krijuar për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi, si dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.³² Komisioneri mbështet punën e tij në zbatimin e të gjitha mekanizmave ligjorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kryen hetim administrativ dhe merr vendime. Komisioneri vendos ndëshkimin me gjobë të subjektit

³² Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", në përputhje me Direktivat e BE në fushën e mosdiskriminimit

përgjegjës për diskriminim në rast mos zbatimi të vendimeve të tij. Në vijim paraqesim për ilustrim të mbrojtjes së lirisë së ndërgjegjes dhe besimit fetar përmbledhjen e një prej vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.³³

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit X, kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fushë-Krujë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “bindjeve fetare”.

Shtetasi X është shprehur se është diskriminuar nga një punonjës i kësaj IEVP-je, pasi ai e shqetëson dhe pengon në ushtrimin e të drejtës së tij për të realizuar ritin e faljes, bazuar në bindjet e tij fetare, si besimtar dhe ndjekës i fesë myslimane. Ligji i posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen

³³ Vendimi i KMD, Nr.76, datë 23.07.2020, gjendet në <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-nr.-76-dat%C3%AB-23.07.2020-R.-M-kund%C3%ABr-IEVP-Fush%C3%AB-Kruj%C3%AB-Mosdiskriminim.pdf>

civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.³⁴

Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak. Nga hetimi administrativ i kryer nga ky institucion ka rezultuar se në IEVP Fushë-Krujë ka një numër të konsiderueshëm të dënuarish që praktikojnë ritet fetare në bazë të besimeve të tyre, vërtetuar kjo me listat e aktiviteteve fetare, të rifreskuara në zbatim të kërkesave të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Këto rite fetare drejtohen nga përfaqësues të miratuar nga religjionet e tyre fetare, ku të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit kryejnë ritet e tyre fetare gjatë një orari të caktuar dhe të miratuar nga Drejtoria e Institucionit.

Nga ana e Institucionit në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme fetare gjatë gjithë kohës janë marrë masa për krenntimin e festave sipas kalendareve fetare duke punuar dhe me orare të zgjatura. IEVP-ja ka rezultuar se ka mjedise për të ushtruar të drejtën e besimit për çdo të dënuar që

³⁴ Neni 10, Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

janë të monitoruara me kamera dhe afati i ruajtjes së pamjeve filmike është 30 ditë. Pamjet filmike për shkak të kalimit të këtij afati për këtë rast konkret nuk janë ofruar. Prej 13 marsit 2020 e në vijim mjediset e rriteve fetare nuk janë lejuar të shfrytëzohen për shkak të gjendjes së shkaktuar nga Covid-19”.

Rregullorja Evropiane e Burgjeve lidhur me kërkesë ankesat e personave të privuar nga liria në sistemin e burgjeve sanksionon se: *“Të burgosurit, individualisht ose si grup, duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa apo ankesa drejtuar drejtorit të burgut ose ndonjë autoriteti tjetër kompetent. Nëse një kërkesë mohohet ose një ankesë refuzohet, të dënuarit duhet t’i ofrohen arsye dhe i dënuari do të ketë të drejtë të ankohet pranë një autoriteti të pavarur”.*

Përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminim. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjjes dhe fesë nuk mund të cëno-

jnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Komisioneri ka vlerësuar se masat e ndërmarra për pezullimin e kryerjes së ritualit të faljes në ambjentet e përbashkëta ku ka grumbullime të të dënuarve, në kuadër të sigurisë së shëndetit dhe jetës së të dënuarve që vuajnë dënimin me heqje lirie pranë IEVP-së, janë objektivist të arsyeshme dhe proporcionale në raport me situatën e krijuar në kuadër të COVID-19 dhe për këtë shkak nuk mund të konsiderohen diskriminuese për asnjërin nga të dënuarit aplikantë të feve të tyre respektive, përfshirë dhe subjektin ankues. Komisioneri në këtë rast vlerësoi se nuk ka shkelje të ligjit.

3.4.4 Avokati i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar për herë të parë në Kushtetutën Shqiptare të miratuar në vitin 1998, kurse ligji “Për Avokatin e Popullit” është miratuar nga Parlamenti Shqiptar në shkurt të vitit 1999.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet

ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Avokati i Popullit jep rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi i administratës publike që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e saj. Në rastet kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, deri edhe Kuvendit (Parlamentit) me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

Për ilustrim të temës së këtij manuali po paraqesim në mënyrë të përmbledhur një rast hetimi administrativ nga ky institucion të nisur me vetiniciativë bazuar në një shkrim në Gazetën Shqiptare në vitin 2018.³⁵

³⁵ Hetimin Administrativ Rreth Shkrimit Në Gazetën Shqiptare, Me Titull “Mjekja Refuzon Punën Me Infermieren Me Shami”, 2018, gjendet në <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/sh%C3%ABndet%C3%ABsia/20>

Në këtë shkrim bëhej fjalë për një incident ndodhur ndërmjet një mjekjeje dhe infermieres që punonte me të, e cila ndjek besimi mysliman dhe mban shami. Midis tyre ka patur një përplasje pasi mjekja ka deklaruar se institucioni shëndetësor është laik dhe se nuk pranohen femrat e mbuluara me shami. Incidenti fillimisht ka degraduar në konflikt më të ashpër, por më pas mosmarrëveshja është zgjidhur.

Avokati i Popullit deklaron se nisur nga legjislacioni i brendshëm për këtë liri individuale dhe neni 18 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut ku parashikohet se : “Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë, kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, vetëm për vetëm apo bashkarisht si në publik ashtu edhe privatisht, nepermjet arsimit, praktikave, kultit dhe kryerjes së riteve”, jep rekomandimin për marrjen e një mase disiplinore ndaj mjekes dhe angazhimin e ndërgjegjësimin e të gjitha strukturave shëndetësore, për mospërsëritjen e rasteve të diskriminimit jo vetëm ndërmjet personelit mjekësor, por edhe ndaj pacientëve që këto struktura trajtojnë. ***Sipas raportimit të Avokatit të Popullit ky rekomandim u mor parasysht dhe u zbatua nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2018.***

3.4.5 Gjykata Kushtetuese

Në bazë të Kushtetutës,³⁶ Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: *g) organeve të bashkësive fetare; individëve.*³⁷ Këto subjekte të së drejtës mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata Kushtetuese nuk ka patur vendimarrje në lidhje me lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.³⁸

4. Detyrimet e Shqipërisë në kuadër të KEDNJ-së

Kuadri normativ në Shqipëri është hierarkik dhe ligji kushtetues zë vendin parësor. Gjithë baza ligjore dhe nënligjore janë në varësi të parashikimeve dhe kufizimeve që dikton Kushtetuta.

³⁶ Neni 131, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

³⁷ Neni 132, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

³⁸ Gjykata Kushtetuese, Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë http://www.gjk.gov.al/web/NENI_9_Liria_e_mendimit_e_ndergjegjes_dhe_e_fese_1745_1.php

Bazuar në Kushtetutë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë një vend të rëndësishëm në rendin ligjor duke u radhitur në hierarkinë e normave menjëherë pas Kushtetutës, duke pasur në këtë mënyrë epërsi mbi ligjet e brendshme që nuk pajtohen me to. Në rastin e KEDNj ka një përjashtim të parashikuar nga vetë Kushtetuta.

Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe se këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.³⁹ Sikurse shihet nga ky parashikim, Kushtetuta shqiptare i referohet drejtpërdrejtë kësaj konvente.

Në një pjesë të posaçme të këtij Manuali i referohemi më gjerësisht KEDNj-së dhe jurisprudencës së GjED-Nj-së përsa i takon lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Në rastin e shkeljeve të pretenduara ndaj këtyre lirive dhe mbas shterimit të ankimit dhe gjyqimit të brendshëm mund të bazohemi tek kjo Kon-

³⁹ Neni 17, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

ventë dhe drejtohem i tek kjo Gjykatë, përkatësisht si instrumenti dhe mekanizmi që mbrojnë, garantojnë lirinë e mendimit, ndërgjegjës dhe fesë.

Si anëtare e Këshillit të Europës, Shqipëria është bërë palë në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollat shtesë.⁴⁰ Ky instrument paraqet një rëndësi shumë të madhe në drejtim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri në disa aspekte.

5. Kodi Penal në mbrojtje të lirisë së mendimit, ndërgjegjës dhe fesë

Kodi Penal parashikon figurat e veprave penale kundër lirisë së besimit në tre nene të tij.⁴¹

Bazuar në liritë e parashikuara në Kushtetutë, Kodi Penal vijon me plotësimin e kuadrit ligjor në mbrojtje të këtyre lirive e të drejtave përfshirë liritë fetare. Kështu, ndërsa në Kushtetutë lejohet organizimi i veprimtarive të organizatave fetare, Kodi Penal parashikon ndëshkim për këdo që ndalon ushtrimin e këtyre veprimtarive. Në veprimtaritë e

⁴⁰ Ratifikuar me ligjin nr 8137, datë 31.7.1996

⁴¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

organizatave fetare do të kuptojmë ato të lutjes, arsimit fetar etj. Që përfshihen e parashikohen edhe në marrëveshjet e posaçme me secilën nga bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e Shqipërisë.

Ndalimi i veprimtarive të organizatave fetare, si dhe krijimi i pengesave për ushtrimin e lirë të veprimtarive të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.⁴²

Një mbrojtje e posaçme i kushtohet objekteve të kultit, pasi janë mjedise dhe objekte ku besimtarët mund të mblidhen, falen, diskutojnë dhe predikojnë besimin përkatës.

Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i objekteve të kultit, kur ka shkaktuar humbjen plotësisht ose pjesërisht të vlerave të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.⁴³

Parashikimi i fundit, por jo për nga rëndësia lidhet me individët, mbrojtjen që ju ofrohet për të ushtruar të lirë të drejtat dhe liritë vetjake në lidhje me besimin fetar. Në këtë rast parashikohet se figura e veprës penale është kundërvajtje.

⁴² Neni 131, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

⁴³ Neni 132, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ndalimi ose krijimi i pengesave që u bëhen personave për të marrë pjesë në ceremonitë fetare, si dhe për të shprehur lirisht bindjet fetare, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.⁴⁴

6. Vlerësimi i lirive fetare në Shqipëri – Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit (2020)

Çdo vit Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes Departamentit të Shtetit përgatisin një raport mbi liritë fetare në botë. Lidhur me Shqipërinë ky raport deklaroi se shteti legalizoi 92 ndërtesa në pronësi të grupeve fetare gjatë vitit të kaluar krahasuar me 164 të tilla në vitin 2019, ndërsa statusi i 32 pronave shtesë mbeti nën shqyrtim. Gjithashtu, raporti nënvizon se korrupsioni, mungesa e njohurive për kompetencat dhe juridiksionin në rastet e pronës, dhe të mëdha ngarkesat në sistemin gjyqësor penguan aftësinë e komuniteteve fetare për të kërkuar pronat e tyre, sipas burimeve të shumta të shoqërisë civile. Drejtuesit e VUSH raportuan vështirësi të vazhdueshme në marrja e lejes për ndërtimin e mjediseve të adhurimit si dhe problemet në lidhje me tarifatat e qeverisë komunale.

⁴⁴ Neni 133, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Komuniteti Bektashi dhe Komuniteti Mysliman Shqiptar raportuar për probleme hasur në mbrojtjen e titullit të pronave të caktuara. KMSH raportoi se qeveria mohoi kërkesën e saj për leje për të ndërtuar një kampus të ri për Universitetin Bedër, i kërkuar që në fillim të vitit 2018.⁴⁵

Kisha Ortodokse raportoi se kishte pretendime për 890 prona. KMSH raportoi se që nga viti 2016 kishte paraqitur afërsisht 500 kërkesa që kishin të bënin me afërsisht 23,000 hektarë pronë dhe po ndiqte 15 procese ligjore. Kisha Katolike raportoi katër raste shqyrtimi gjyqësor, dy prej të cilave nuk kishin kaluar ende për gjykim.

Legjislacioni u lejon komunitetet fetare të hapin institucione arsimore, si dhe të ndërtojnë dhe menaxhojnë varrezat fetare në tokën që kanë në pronësi. Me ligj, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit duhet t'i licencojë këto institucione dhe kurrikulat jofetare duhet të jenë në përputhje me standardet kombëtare të arsimit. Komunitetet katolike, myslimane, ortodokse dhe VUSH operonin kopshte, shkolla dhe universitete të shumta të licencuara nga

⁴⁵ International Religious Freedom Report for 2020 United States Department of State, Chapter on Albania <https://www.state.gov/reports/2020-report-on-international-religious-freedom/albania/fq.1>

shteti. Shumica e këtyre nuk i kanë të detyrueshme lëndët e fesë, por i ofrojnë me zgjedhje. KMSH drejton katër medrese që mësojnë fenë, përveç kurrikulës së detyrueshme nga shteti.⁴⁶

Një shqetësimin i shprehur nga komunitetet është se qeveria ende nuk i nje diplomat në teologji dhe studime fetare të fituara përmes institucioneve arsimore të huaja.⁴⁷

Ndërsa Shqipëria ka bërë përpjekje të suksesshme për plotësimin e kuadrit ligjor lidhur me lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, si në aspektin individual, ashtu edhe atë kolektiv – të komuniteteve fetare, në praktikë ka edhe vend për përmirësime dhe rezultate pozitive për të drejta të tjera të lidhura me gëzimin dhe ushtrimin pa pengesa të lirisë së ndërgjegjes dhe besimit, sikundër janë e drejta për arsim, apo edhe e drejta e pronës.

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ International Religious Freedom Report for 2020 United States Department of State, Chapter on Albania <https://www.state.gov/reports/2020-report-on-international-religious-freedom/albania/> fq.6



BIBLIOGRAFIA

Legjislacion shqiptar

- » Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 8417, datë 21.10.1998, miratuar me referendum më 22.11.1998, shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012, ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ndryshuar me ligjin nr. 115/2020, datë 30.07.2020
- » Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- » Ligj nr. 8902, datë 23.5.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së

Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”

- » Ligj nr.10056, datë 22.1.2009 Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”
- » Ligj nr.10057, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”
- » Ligj nr.10058, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bekdashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”
- » Ligj nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
- » Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 23.09.1999, për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet, ndryshuar me VKM nr. 128, dt. 14.03.2004, ndryshuar me VKM nr. 666, dt. 26.10.2005, ndryshuar me VKM nr. 344, dt. 07.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1029, dt. 27.11.2013, ndryshuar me VKM Nr. 1029, dt. 27.11.2013, ndryshuar me VKM Nr. 602, dt. 10.09.2014.

Akte normative ndërkombëtare

- » Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara, 1948
- » Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Kombet e Bashkuara, 1966
- » Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, 1950
- » Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2000

Botime

- » Udhëzues për Nenin 9 - Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, Këshilli i Evropës/ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2015, https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_9_SQL.pdf
- » Gjykata Kushtetuese, Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë http://www.gjk.gov.al/web/NENI_9_Liria_e_mendimit_e_ndergjegjes_dhe_e_fese_1745_1.php
- » <https://www.zaninalte.al/2013/09/liria-e-fese-ne-kontekstin-e-modelit-euro-pian-te-merredhenieve-ndermjet-shtetit-dhe-fese/>
- » Evalda Jera, Freedom of Religion and Social Conflict. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 3(3), 2014, 553 ISSN 2039-2117

<https://www.richtmann.org/journal/index.php/ajis/article/view/3835>

- » Gjergj Sinani, Feja dhe Edukimi, Fondacioni “Friedrich Ebert”, Albdesing, Tiranë 2017, <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/13999.pdf>
- » Komiteti Shtetëror për Kultet <https://kshk.gov.al/kreu/baza-ligjore/>
- » <https://vush.al/wp-content/uploads/2020/08/Marreveshja-e-Ratifikuar-ne-Parlament.pdf>
- » Hetimin Administrativ Rreth Shkrim-it Në Gazetën Shqiptare, Me Titull “Mjek-ja Refuzon Punën Me Infermieren Me Shami”, 2018, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/sh%C3%ABndet%C3%ABsia/20>
- » Vendim i KMD, Nr. 76 , datë 23.07.2020, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-nr.-76-dat%C3%AB-23.07.2020-R.-M-kund%C3%ABr-IEVP-Fush%C3%AB-Kruj%C3%AB-Mosdiskriminim.pdf>
- » Jim Murdock, Freedom of thought conscience and religion, A guide to the implementation of Article 9 of the European Convention on Human Rights <https://rm.coe.int/168007ff4f>

- » Rapporteur's Digest on Freedom of Religion or Belief <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Religion/RapporteursDigestFreedomReligionBelief.pdf>
(<https://www.ohchr.org/en/issues/freedomreligion/pages/standards.aspx>)
- » <http://hrlibrary.umn.edu/edumat/studyguides/religion.html>
- » <https://humanrights.gov.au/our-work/rights-and-freedoms/freedom-thought-conscience-and-religion-or-belief>
- » <https://www.ag.gov.au/rights-and-protections/human-rights-and-anti-discrimination/human-rights-scrutiny/public-sector-guidance-sheets/right-freedom-thought-conscience-and-religion-or-belief>
- » Freedom of religion or belief: Laws affecting the structuring of religious communities Organization for Security and Co-operation in Europe Review Conference, September 1999 ODIHR Background Paper 1999/4, Cole Durham <https://www.osce.org/files/f/documents/4/7/16698.html>
- » Restoring Freedom of Conscience, Rafael Domingo, Journal of Law and Religion, Vol. 30, No. 2 (JUNE 2015), pp. 176-193 (18 pages),

Published By: Cambridge University Press
<https://www.jstor.org/stable/24739203>

- » Të dhëna mbi shkollat fetare në Shqipëri
<https://www.acce.al/sq/research/te-dhena-mbi-shkollat-fetare-ne-shqiperi>
- » Raporti Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë
- » <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2017-Raporti-Liria-e-Fese-Shqiperi-FINAL.pdf>
- » Raporti studimor: Promovimi i Mirëkuptimit, Tolerancës Fetare në Shqipëri, 2019 https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/11/Raport-Studimor_Promovimi-i-mir%C3%ABkuptimit-toleranc%C3%ABs-dhe-liris%C3%ABfetare-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri_compressed.pdf
- » Elvin Gjevori & Ina Xhepa, Manual - E drejta për Arsim, KAS & Fondacioni Qendra Europiane, Tiranë, 2020 <https://www.kas.de/documents/271859/271908/Recht+auf+Ausbildung.pdf/144285bd-0a01-3e7f-d422-3dfa8e-30a47e?version=1.0&t=1607352541309>
- » Toleranca Fetare në Shqipëri, IDM & UNDP, 2018 [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/religious tolerance](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance)

- » International Religious Freedom Report for 2020 United States Department of State, Chapter on Albania
<https://www.state.gov/reports/2020-report-on-international-religious-freedom/albania/>

